

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER:



TEZA MASTER

Metodat e punës dhe sfidat për menaxhimin e sjelljeve të
papërshtatshme të nxënësve

Mentori/ja:

Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli

Kandidati/ja:

Mjellma Shala

Prishtinë, 2022

© 2021-Mjellma Shala Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ABSTRAKTI

Një prej problemeve më të përhapura në arsim gjatë viteve të fundit janë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve. Do të ishte gabim nëse mësimdhënësit do të përpiqen të vendosin disiplinën duke e imponuar atë, si një mënyrë për të zvogëluar sjelljen e padëshiruar. Rëndësia kryesore e qëllimit të studimit të këtij problemi është aftësimi i mësimdhënësve për mënyrën e menaxhimit të sjelljeve të papërshtatshme përmes përdorimit të metodave sa më efikase.

Në kapitullin e dytë të këtij studimi është konsultuar një gamë e gjerë e literaturës, e bazuar në shumë studime e hulumtime të ndryshme bashkëkohore të cilat vënë në theks thelbin e mësimdhënies cilësore e cila përbën zemrën e vendosjes së disiplinës.

Ky hulumtim ka për qëllim të vërtetoj se në çfarë mase janë të përhapura sjelljet e papërshtatshme, me çfarë sfida mësimdhënësit përballen dhe çfarë metoda përdorin për zvogëlimin dhe shmangien e këtyre sjelljeve. Për t'i arritur këto qëllime, kemi përdorur metodën kuantitative, ku përmes instrumentit të pyetësorit kemi mbledhur të dhënat sasiore parësore nga mostra e përzgjedhur. Në fokus të analizës janë zgjedhur 14 institucione edukativo-arsimore dhe 150 mësimdhënës të ciklit të ulët të komunës e Prizrenit. Pjesëmarrësit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, i janë nënshtruar pyetësorit, i cili përbëhej prej pyetjeve të tipit të mbyllur, të formuluar në përputhje të plotë për të iu shërbyer qëllimeve, pyetjeve hulumtuese dhe hipotezave të këtij punimi. Të dhënat janë analizuar përmes paketës SPSSv.25. duke përdorur analizën faktoriale dhe testin H_i^2 për vërtetim të hipotezave. Karakteristikat e gjithë hulumtimit përcaktohen në detaje në kapitullin e tretë dhe të katërt që i takojnë Metodologjisë së punës dhe Analizës së të dhënave.

Në bazë të rezultateve arrijmë në përfundim se sjelljet e papërshtatshme janë të përhapura shumë në klasa, mësimdhënësit sfidohen dhe iu shmangen atyre duke përdorur metodat të ndryshme për trajtimin e tyre andaj edhe në fund kemi dhënë rekomandimet e duhura profesionistëve dhe institucioneve shtetërore që të ndërmarrin masa të duhura për përmirësimin, parandalimin dhe reduktimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve.

Fjalët kyçe: *Disiplina, metodat e punës, sfida, sjelljet e papërshtatshme.*

ABSTRACT

One of the most prevalent problems in education in recent years is the inappropriate student behaviour. It would be wrong for teachers to try to establish discipline by imposing it, as a way to reduce unwanted behaviour. The main importance of the purpose of studying this problem is to train teachers on how to manage inappropriate behaviours through the use of the most efficient methods.

In the second chapter of this study a wide range of literature is consulted, based on many different contemporary studies and research which emphasize the essence of quality teaching which is the heart of establishing discipline.

This research aims to verify the extent to which inappropriate behaviours are prevalent, what challenges do the teachers face and what methods do they use to reduce and avoid these behaviours. To achieve these goals, we used the quantitative method, where through questionnaire instrument we collected the primary quantitative data from the selected sample. In the focus of the analysis, 14 educational institutions and 150 primary school teachers of Prizren Municipality were selected. Randomly selected participants were objected to a questionnaire, which consisted of close-ended questions, formulated in full accordance to serve the purposes, research questions and hypotheses of this work. Data were analysed through SPSSv.25. package, using factor analysis and H_i^2 test to confirm the hypotheses. The characteristics of the whole research are defined in detail in the third and fourth chapters belonging to the Work Methodology and Data Analysis.

Based on the results, we conclude that inappropriate behaviours are widespread in the classroom, teachers are challenged and avoid it by using different methods for their treatment, hence in the end we have given the appropriate recommendations to professionals and state institutions to take the necessary actions for improving, preventing, and reducing the inappropriate student behaviour.

Keywords: *Discipline, working methods, challenges, inappropriate behaviors.*

FALËNDERIMI

Duke lënë pas meje shumë sfida dhe kujtime dua të falënderoj “Universitetin e Prishtinës” që më mundësoi përfundimin e studimeve dhe gjithë profesorët të cilët me punën e tyre të vlefshme dhanë kontribut në avancimin tim në këtë nivel studimi.

Një falënderim të veçantë ua dedikoj mentores sime Prof. ass. dr. Ardita Devolli, e cila gjithmonë dhe në çdo kohë ishte e gatshme të më ndihmoj dhe të më udhëzoj për finalizimin e këtij studimi. Profesionalizmi, njohuritë dhe përvoja e saj ishin udhërrëfim në perspektivën time akademike dhe profesionale. Gjithashtu, falënderoj edhe anëtarët e komisionit për vlerësimin e temës sime të masterit Prof. asoc. dr. Naser Zabeli dhe Prof. ass. dr. Teuta Danuza.

Falënderoj miqtë dhe kolegët ata që më dhanë mbështetje në çdo aspekt, e pa i harruar edhe dy koleget, shoqe të zemrës Ardora Haskuka dhe Suada Kryeziu të cilat i dhanë hijeshi çdo hidhërimi e vlerë çdo gëzimi të përjetuar gjatë kësaj periudhe studimi.

Në fund, por jo më pak e rëndësishme është familja ime, ata që i kam dhe që do të doja ti kem gjithmonë afër! U jam falënderuese me gjithçka që kam për mundin, sakrificën, besimin dhe përkrahjen të pafundme gjatë gjithë këtij rrugëtimi.

Ju falënderoj nga thellësia e zemrës!

Përmbajtja

I. HYRJE.....	2
Qëllimi i hulumtimit.....	3
Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat	3
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
Sjelljet e papërshtatshme	4
Shkaqet e shfaqjes së sjelljeve të papërshtatshme	5
Menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve.....	7
Metodat psiko-pedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme	8
Disiplina assertive.....	9
Injorimi i sjelljes së papërshtatshme ose mësimdhënia demokratike	10
Modifikimi i sjelljes ose metoda skineriane	11
Terapia realiste	12
Vetëkontrolli i sjelljes.....	14
Disiplina me dinjitet ose kontrata sociale.....	15
Faktorët që ndikojnë në klimën pozitive në klasë	16
III. METODOLOGJIA.....	18
Mostra.....	18
Instrumentet.....	20
Procedurat.....	20
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET	21

Rezultatet deskriptive	21
Vërtetimi i hipotezave	38
Testimi i hipotezës së parë	38
Testimi i hipotezës së dytë	41
Testimi i hipotezës së tretë	44
V. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET	53
Kufizimet e studimit.....	55
Hulumtimet në të ardhmen	56
Implikimet praktike nga studimi	56
VI. BIBLIOGRAFIA	57
SHTOJCA: PYETËSORI	62

Lista e tabelave

Tabela 1. Numri i pjesëmarësve në hulumtim sipas shkollave	19
Tabela 2. Institucionet e punës së mësimdhënësve	22
Tabela 3. Vendi i punës së mësimdhënësve	23
Tabela 4. Gjinia e mësimdhënësve	23
Tabela 5. Grupmosha e mësimdhënësve në hulumtim	24
Tabela 6. Niveli i shkollimit	24
Tabela 7. Përvoja e punës	25
Tabela 8. Përhapja e sjelljeve të papërshtatshme	25
Tabela 9. Sfida e mësimdhënësve me sjelljet të papërshtatshme të nxënësve	26
Tabela 10. Nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e dhëna	26
Tabela 11. Nxënësit në klasë flasin pa leje	27
Tabela 12. Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare	27
Tabela 13. Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin	28
Tabela 14. Opinione të mësimdhënësve lidhur me zhurmën e krijuar në klasë	28
Tabela 15. I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë	29
Tabela 16. Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre	29
Tabela 17. Injoroj sjelljen e papërshtatshme të nxënësve	30
Tabela 18. Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme	30
Tabela 19. Fokusohe vetëm në veprimet e papërshtatshme të nxënësve	31
Tabela 20. Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës	31
Tabela 21. Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e papërshtatshme	32
Tabela 22. Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre	32
Tabela 23. Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë	33
Tabela 24. Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve	33
Tabela 25. Përdorimi i strategjive parandaluese për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese	34
Tabela 26. Rezultatet e testit të KMO dhe Bartlet lidhur me përhapjen e sjelljeve të nxënësve	38
Tabela 27. Klasifikimi i ndryshoreve në kategori	38
Tabela 28. Analiza e ndryshoreve	40
Tabela 29. Vërtetimi i hipotezës së dytë përmes testit H_i^2	41
Tabela 30. Vërtetimi i hipotezës së tretë përmes testit H_i^2	45

Lista e figurave

Figura 1. Qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve	35
Figura 2. Opinionet e mësimitdhënësve për modifikimin e sjelljeve të papërshtatshme	37
Figura 3. Klasifikimi i ndryshoreve në faktorë kryesor	39
Figura 4. Sjelljet e papërshtatshme të nxënësve e krahasuar me gjininë e mësimitdhënësve	42
Figura 5. Krijimi i zhurmës në klasë krahasuar me gjininë e mësimitdhënësve	43
Figura 6. Sfidat e mësimitdhënësve nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë	44
Figura 7. Qëndrimi i mësimitdhënësve në mësim gjatë paraqitjes së sjelljeve të papërshtatshme	46
Figura 8. Vendosja e rregullave të klasës bashkë me nxënësit	47
Figura 9. Diskutimi i sjelljeve të papërshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme	48
Figura 10. Inkurajimi i nxënësve për vetëvlerësimin e sjelljeve nga ana e mësimitdhënësve	49
Figura 11. Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë	50
Figura 12. Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve	51
Figura 13. Përdorimi i strategjive parandaluese ndaj sjelljeve sfiduese	52

I. HYRJE

Disiplina luan një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e mësimit në klasë andaj çështja më e rëndësishme që duhet të mbahet në mendje për disiplinën është që krijimi i rregullit të nevojshëm ka të bëjë më shumë me mjeshtëritë e mësimit sesa me suksesin në përgjithësi, sesa me korrigjimin e sjelljeve jo të përshtatshme të nxënësve. Pra, nëse veprimtaritë në klasë planifikohen mirë, paraqitja e mësimit mban të përqendruar vëmendjen e nxënësve, interesin dhe përfshirjen e plotë të tyre atëherë edhe sjelljet e papërshtatshme mund të paraqiten në masë më të vogël.

Në një kohë ku për shumë gjëra mund të gjejmë zgjidhje është mëkat të themi: “Nuk mundem”, “Nuk kam çka të bëj”, “Ai/ ajo është ashtu”. Jo, përkundrazi sot ne kemi shumë çka të bëjmë, mësimit bashkëkohore na ofron llojllojshmëri metodash e strategjish me të cilat ne mund ti ndryshojmë gjërat. Kur sjelljet e papërshtatshme ndodhin gjatë viteve të shkollës fillore, është vënë re se ndikon negativisht te aftësitë e deshifimit, në lexim dhe arritje akademike. Kombinimet e këtyre faktorëve janë të lidhura me normat e braktisjes së shkollës (Jimerson, Anderson, & Whipple, 2002). Andaj gjithë mësimit duhet të kenë kujdes sepse pikërisht kjo fazë e nxënësve është vendimmarrëse për gjithë të ardhmen e tyre. Këto arsye kanë qenë pikërisht ato që më kanë nxitur të zgjedhë këtë temë.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të vërtetohet se në çfarë mase janë të përhapura sjelljet e papërshtatshme në klasat tona, si ndikojnë këto sjelljet në arritjet akademike të nxënësve, me çfarë sfida mësimit përballen dhe çfarë metoda përdorin për zvogëlimin dhe shmangien e këtyre sjelljeve.

Ky hulumtim do t'iu shërbejë të gjithë mësimit të cilët doemos në klasat e tyre i kanë apo edhe në të ardhmen do ti kenë të pranishëm fëmijë me sjellje të tilla, kështu menaxhimi i situatës do të bëhet shumë më i lehtë përmes përdorimit të metodave nga më të ndryshmet të cilat iu përgjigjen çdo lloj sjelljeje.

Qëllimi i hulumtimit

Sjelljet e papërshtatshme mbeten të jenë problem aktual i fushës edukativo-arsimore, me të cilat mësimdhënësit sfidohen në çdo kohë dhe situatë. Ato, jo vetëm që shkaktojnë stres për mësimdhënësit ndikojnë negativisht edhe në rrjedhën e procesit mësimor dhe në arritjet akademike të nxënësve. Duke u fokusuar në këtë çështje përmes këtij studimi synohet të vërtetohet fillimisht se në çfarë mase janë të përhapura sjelljet e papërshtatshme, me çfarë sfida ballafaqohen mësimdhënësit dhe cilat janë metodat e punës të cilat ata i përdorin për ti evituar këto sjellje me qëllim që të arrijnë një menaxhim sa më të suksesshëm të klasës. Prapa çdo sjellje që shfaqet fshihet shkaku i saj, mirëpo ne nuk duhet vazhdimisht të gjuajmë shkaku se pse shfaqet një sjellje e papërshtatshme dhe të baraz vlerësojmë nxënësin me sjelljen e tij jo të mirë. Pasi të zbulohet shkaku, qëndron e tërë puna profesionale pedagogjike e jona, trajtimi i sjelljeve të papërshtatshme në mënyrë të duhur dhe përpjekja për të reduktuar shfaqjen e saj.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

- Në çfarë mase janë të përhapura sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë?
- Sa sfidohen mësimdhënësit në klasë gjatë menaxhimit të sjelljeve problematike?
- Cilat metoda përdoren për të menaxhuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve?

Duke u bazuar në pyetjet e hulumtimit, janë parashtruar tri hipoteza:

- **H1** - Sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura shumë në klasa.
- **H2** - Mësimdhënësit sfidohen shumë nga sjelljet e papërshtatshme.
- **H3**- Mësuesit përdorin llojllojshmëri metodash për menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme në procesin mësimor.

Struktura e këtij studimi përfshinë gjashtë kapituj në vete, duke filluar me hyrjen e cila elaboron qëllimin, pyetjet dhe hipotezat e ngritura për këtë hulumtim. Më pas në kapitullin e dytë kemi shqyrtimin e literaturës e cila bazohet në opinione, studime e hulumtime nga autorë të ndryshëm lidhur me çështjen e hedhur në hulumtim. Kapitulli i tretë pasqyron metodologjinë e punës, duke përfshirë në vete mostrën e zgjedhur, instrumentin e përdorur dhe procedurën e

ndjekur. Kapitulli i katërt interpreton analizën e të dhënave dhe rezultateve. Kapitulli i pestë paraqet diskutimin dhe konkludimet duke potencuar kufizimet e studimit, hulumtimet në të ardhmen dhe implikimet praktike nga studimi. Në fund kemi kapitullin e gjashtë i cili pasqyron bibliografinë e shtjelluar të punimit.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Sjelljet e papërshtatshme

Klasa është një mjedis me ekologjinë e vet duke përfshirë mësimdhënësin, nxënësit, pajisjet, aktivitetet të cilat gjithë së bashku kanë lidhshmëri të ngushtë dhe ndikojnë njëra me tjetrën. Fillimisht “sjellja është mënyra se si vepron njeriu në jetë, qëndrimi në marrëdhënie me të tjerët dhe ndaj detyrave të caktuara; veprimtari e mësuar e individit e cila manifestohet në mënyrën e veprimit të tij ndaj objekteve, situatave, ndaj vetes dhe të tjerëve (Grillo, 2002).

Sjelljet e papërshtatshme janë ato sjellje që prishin, pengojnë apo ndalojnë mësimdhënien dhe të nxëniet në klasë. Këto sjellje rrisin nivelin e stresit si për mësimdhënësin ashtu edhe për nxënësit duke ndikuar në rrjedhën e mësimit, qëllimeve, rezultateve mësimore dhe dinamikën e klasës. Literatura përforcon faktin se sjelljet e papërshtatshme në klasë janë një problem i vazhdueshëm për mësuesit, nxënësit, prindërit dhe administratorët. Studiuesit si Hunter-Love (Hunter-Lowe, 2008), Todras (Todras, 2007), Jung e Boman (Jung & Boman, 2003), vënë në dukje shqetësimet gjithëpërfshirëse të shkaktuara nga sjelljet e papërshtatshme. Shqetësimet e tyre lidhen me rrjedhën e procesit mësimor, klimën e klasës dhe fokusin e nxënësve në të nxënë të gjitha këto që ndikohen mjaft shumë nga sjelljet e papërshtatshme.

Termet si “sjellje e papërshtatshme”, “sjellje e mundimshme”, “sjellje problematike”, “sjellje e keqe” janë shumë të pranishme në mjediset tona arsimore. Përndryshe, të gjitha këto terme iu referohen termit “sjellje disruptive”. Në Oxford English Dictionary “sjellja disruptive” përkufizohet si sjellje e vështirë ose problematike nga një person apo grupe. Zakonisht i referohet sjelljes antisociale dhe jo çrregullimit emocional të sjelljes (Simpson & Weiner, 1989). Ndërsa, sipas Cambridge Dictionaries Online “disruptoj” do të thotë të ndalosh diçka, veçanërisht një sistem, proces apo ngjarje dhe të mos e lejojsh të vazhdojë si zakonisht (Walter, 1995).

Houghton dhe të tjerë (Houghton, Wheldall, & Merrett, 1988), si dhe Arbuckle e Little (Little & Arbuckle, 2004) për qëllimet e studimeve të tyre e përkufizojnë sjelljen disruptive si një aktivitet që shkakton stres te mësuesit, ndërpret procesin e të nxënës dhe i çon mësuesit të bëjnë vazhdimisht komente (qortime) për nxënësin.

(Tatum, 1982), miraton një përkufizim më sociologjik të disrupcionit, i cili thekson kontekstin, situatën dhe ndërlikimet ndërpersonale: “Sjellja disruptive është shkelje e rregullave në formën e veprimit ose mosveprimit të vetëdijshëm, i cili sjell një ndërprerje ose shkurtrim të aktivitetit në klasë ose shkollë dhe dëmton marrëdhëniet ndërpersonale”.

Në këtë punim sjelljet e papërshtatshme do të konsiderohen sjelljet të cilat janë të vazhdueshme të cilat pengojnë marrëdhëniet shoqërore, komunikimin dhe mësimin e një fëmije.

Sjelljet e papërshtatshme të cilat do të shqyrtohen në këtë studim janë:

1. *Agresioni* → sulme fizike dhe verbale kundrejt mësuesit ose nxënësve të tjerë.
2. *Imoraliteti* → veprime si kopjim, gënjeshtria dhe vjedhje.
3. *Mosbindja ndaj autoritetit* → refuzues, ndonjëherë armiqësor kundrejt kërkesave të mësueses.
4. *Disrupcioni në klasë* → të folurit me zë të lartë, të thirrurit me zë të lartë, të ecurit rreth e rrotull, të hedhurit e objekteve.
5. *Shmangia e punëve* → sorollatje, mosbërja e detyrave të caktuara, stërzgjatja e veprimtarive.

Shkaqet e shfaqjes së sjelljeve të papërshtatshme

Ndër shkaqet më kryesore të sjelljes së padëshiruar janë: mërzitja, përpjekja mendore e zgjatur, paaftësia për të bërë detyrën, të qenët i shoqërueshëm, vetëvlerësimi i ulët, vështirësitë emocionale, etj. (Musai, 2003).

(Dreikurs, 1968), thekson se nxënësit shfaqin sjellje të papërshtatshme për disa qëllime si: tërheqja e vëmendjes së mësuesit, kërkimi i autoritetit duke kundërshtuar mësuesin, hakmarrja, ndjenja e dështimit.

Sipas Glasser (Glasser, 1998), nxënësit manifestojnë sjellje të papërshtatshme në shkollë nga fakti se ata nuk arrijnë t'i plotësojnë nevojat e tyre dhe po aq sa është e rëndësishme nevoja për liri, dashuri, fuqi dhe kontroll, është edhe nevoja për kënaqësi.

Gordon (Gordon, 1991), thekson se qasja autoritare ndaj nxënësit bën që ai të shpërthejë me sjellje të papërshtatshme deri në agresivitet. Mësimdhënësi që zbaton një disiplinë autoritare ndaj nxënësit për kundërveprime, ai do të humb disponimin, do të tërhiqet në vetvete apo do të “rebelohet” në forma të ndryshme dhe do të krijojë situata të vështira për mësimdhënësin dhe të tjerët.

Në raportin e përfunduar nga Elton (Elton, 1989) u vërtetua se 80% e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në Mbretërinë e Bashkuar ishin si rezultat i planifikimit dhe organizimit të dobët të procesit mësimor në klasë nga ana e mësimdhënësve. Sipas këtij raporti mësuesit britanikë kanë potencuar se sjelljet më të shpeshta janë ato të folurit pa leje dhe jashtë rradhe nga nxënësit të cilat po shkaktojnë stres të madh te mësimdhënësit.

Një sondazh i realizuar në vitin 2016 në Amsterdam (Abrahamse, Junger, Wouwe, Boer, & Lindauer, 2015) zbuloi se çrregullimet më të përhapura tek adoleshentët ishin sjelljet e papërshtatshme ku shkalla e përhapjes ishte 8.5% te djemtë dhe 7.1% te vajzat. Ndërsa një hulumtim i publikuar te “Revista e Psikologjisë Klinike të Fëmijëve dhe Adoleshentëve” zbuloi se karakteristikat personale, të tilla si prindërimi jo përshtatës, parashikojnë sjellje përçarëse (Molen, Hipewell, & Rolf, 2011).

Një studimi i realizuar në Iran në vitin 2015 me pjesëmarrje nga 600 studentë - nga 15 deri në 18 vjeç, të cilët jetonin në Saveh, synonte të përcaktonte mbizotërimin e sjelljes problematike midis një mostre të rinjve iranianë dhe lidhjen e sjelljes së papërshtatshme me fenomenet e tjera psikologjike. Sipas rezultateve të këtij studimi, u zbuluan dallime të rëndësishme gjinore në sjelljen përçarëse midis adoleshentëve iranianë, e cila është në përputhje me hulumtimet e mëparshme në vendet e tjera mbi sjelljen e papërshtatshme të adoleshentëve gjithashtu përmes këtij studimi është vërtetuar se sjelljet e papërshtatshme tek adoleshentët shfaqen si rezultat i depresionit, stresit, mos kënaqësia nga jeta (Araban, Montazeri, Stein, Karimy, & Mehrizi, 2020).

Menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve

Sa i përket sfidave të mësimdhënësve në menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme, Rather (Rather, 2004), thekson se mësimdhënia është një proces tripolar, që përfshin mësuesin, nxënësin dhe situatën e të mësuarit dhe që çon në ndryshimin e sjelljes së nxënësit. Duke ditur se menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme është i lidhur ngushtë me konceptin e menaxhimit në tërësi është e rëndësishme të trajtohet ky koncept. Sipas Fayol (Fayol, 1949), menaxhimi është parashikim, planifikim, organizim dhe kontrollim i aktiviteteve të tjerëve.

Interpretimet teorike tek “Metodologjia e mësimdhënies” e definojnë menaxhimin në këtë mënyrë: “Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të nxënësve duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim” (Musai, 2003).

Menaxhimi i klasës mund të analizohet në pesë dimensione si rendi fizik i një klase, aktivitetet e planifikimit, aktivitetet për menaxhimin e kohës, rregullimi i marrëdhënieve dhe rregullimi i qëndrimeve (Basar, 1994).

Kounin (Kounin, 1970), ka një zbulim interesant në studimin e tij, pasi që në 92% të rasteve mësuesit nuk japin arsye se pse e quajtën të gabuar sjelljen e një nxënësi.

Përgjatë vlerësimit multifaktorial të cilësisë së arsimit në shkollat 9-vjeçare shqiptare (Tamo & Karaj, 2007), 67% e vëzhguesve pohuan se mësuesit tërheqin herë pas here vëmendjen për ruajtjen e qetësisë në klasë, ndërsa 45% e vëzhguesve vënë re se nxënësit nuk qëndrojnë në heshtje gjatë shpjegimit dhe shpërqendrohen nga tema të tjera.

Në të kaluarën, disiplina shkollore është përqendruar kryesisht te kundërpërgjigja ndaj sjelljes së keqe të një nxënësi të caktuar, duke vënë në zbatim strategjinë ndëshkimore, duke përfshirë qortimet, heqjen e privilegjeve, dërgimet në drejtori, pezullimet dhe përjashtimet. Studimet kanë treguar se zbatimi i një mase ndëshkimore nuk është e dobishme. Gjëja më e dobishme që mësuesit duhet të bëjnë për të trajtuar sjelljet problematike, është në radhë të parë ta parandalojnë atë. Prezantimi, modelimi dhe përforcimi i sjelljes shoqërore pozitive është një hap i rëndësishëm në përvojën edukative të një nxënësi. Nxënësve u tregohen pritshmëritë që ka shkolla për sjelljen e tyre dhe nëse ata përgëzohen në momentin që sillen bazuar në rregulla, sjellja e tyre do të forcohet në drejtim pozitiv (Rogers & McPherson, 2014).

Një hulumtim i realizuar në Zelandën e Re, 88% e mostrës prej 42 mësimeve vlerësojnë keq menaxhimin në klasë si “ndonjëherë” dhe “shumë shpesh” një shkak i sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në klasë. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim kishin pasur trajnime minimale rreth menaxhimit të sjelljeve të papërshtatshme (Johansen, Little, & Little, 2011).

Fjala metodë rrjedh prej gjuhës greke *methodos* që në shqip do të thotë: rrugë, mënyrë, aspekt, qëndrim, drejtim për të kuptuar dhe transmetuar një informacion të ri, për të realizuar detyrat dhe veprimtaritë. Në këtë punim metodat e punës do të cilësohen të gjitha mënyrat dhe ecuritë që do të përdoren gjatë mësimit me qëllim të reduktimit të sjelljes së papërshtatshme të nxënësve në klasë dhe përfshirjes sa më aktive të tyre në procesin mësimor.

Nxënësit i sjellin në shkollë të gjitha llojet e shqetësimeve, reagimeve dhe modeleve të sjelljeve të ndryshme të krijuara, lejuara apo edhe të mbështetura jashtë klasës. Ata mësojnë të sillen ndryshe nëse sinjalizohen, inkurajohen dhe mbështeten sjelljet e duhura në çdo mjedis të caktuar.

Metodat psiko-pedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme

Sipas Zabeli (Zabeli, 2008), sjelljet e papërshtatshme të nxënësve mund të ndodhin në çdo kohë dhe rrethanë që shfaqen si pasojë e ndikimit të shumë faktorëve, metodat psiko-pedagogjike të cilat mund të përdoren me qëllim të reduktimit apo edhe përmirësimit të sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në klasë janë:

- Disiplina assertive
- Injorimi i sjelljes së papërshtatshme ose mësime demokratike
- Modifikimi i sjelljes ose metoda skineriane
- Terapia realiste
- Vetëkontrolli i sjelljes
- Disiplina me dinjitet ose kontrata sociale

Disiplina assertive

Themeluesit e disiplinës assertive Lee Canter dhe Marlene Canter në librin e tyre “Positive behavior management for today’s classroom” theksojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në klasë, duke vendosur rregulla, duke respektuar të drejtat e nxënësve dhe duke i përkrahur mësimdhënësit që të ndihen të qetë dhe të përgjegjshëm në punën e tyre (Canter & Canter, 2001). Ata pohojnë se disiplina në klasë është më e lehtë për tu arritur atëherë kur nxënësit i besojnë dhe respektojnë mësuesin e tyre. Nxënësit duhet tu besojnë në fillim mësuesve me qëllim që më pas të pranojnë autoritetin e tyre moral për të vendosur rregulla.

Besimi mund të ndërtohet nëpërmjet njohjes së nxënësve, përshëndetjes së tyre me emër, mësimit të interesave të tyre, bërjes së bisedave personale, njohjes së ditëlindjeve dhe ngjarjeve të veçanta (Canter, 2014). Sjelljet duhet të mësohen përmes udhëzimeve të modeluara dhe të drejtpërdrejta. Për të fituar besimin e nxënësve, mësuesit duhet të sillen gjithmonë brenda udhëzimeve të rregullave që kanë përcaktuar duke modeluar sjelljen pozitive dhe duke përsëritur atë. Përderisa disiplina asertive krijon rrethana të përshtatshme për nxënësit me autizëm të cilët kërkojnë rregull dhe siguri në anën tjetër dallimet individuale të nxënësve dhe planet e individualizuara shpesh injorohen (Canter & Canter, 2001).

Sipas këtyre autorëve, Hierarkia e Disiplinës u ndihmon mësimdhënësve se si të përdorin qasjen e tyre. Kjo hierarki ndryshe njihet edhe si një procedurë e përshkallëzimit të ashpërsisë. Ai përfshin fillimin me veprime të vogla disiplinore siç janë paralajmërimet për shkeljet e para. Nëse nxënësit vazhdojnë të thyejnë rregullat, ashpërsia e disiplinës do të përshkallëzohet. Herën e parë që nxënësi thyen rregullat, mësuesi lëshon një paralajmërim duke ua kujtuar sjelljen e duhur. Kur shkeljet e rregullave vazhdojnë ato duhet të përcillen me pasoja që mund të jetë edhe humbja e një privilegji gjatë ditës. Në qoftë se sjelljet vazhdojnë atëherë Canter dhe Canter sugjerojnë thirrjen e prindit, ku nxënësi duhet të bëjë thirrjen dhe të shpjegoj veten në telefonatë (Canter & Canter, 1993). Edhe pse kjo qasje në mënyrë tipike shihet si një program autoritar, tani ajo shihet si më demokratike dhe bashkëpunuese duke ruajtur mjedisin përgjegjës për mësuesit (Griffiths, Millei, & John, 2010). Robert J. Marzano, autor dhe CEO në Laboratorin hulumtues në Marzano theksoi se disiplina asertive është gjithëpërfshirës dhe vizionare

Injorimi i sjelljes së papërshtatshme ose mësimdhënia demokratike

Metodën e mësimdhënies demokratike e zhvilloi psikiatri dhe edukatori i njohur austriak Rudolf Dreikurs. Sipas kësaj metode, mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis demokratik, një klasë me klimë të favorshme për të gjithë ku sjelljet e papërshtatshme redukohen duke mos ndërmarrë ndëshkime, duke injoruar sjelljen e papërshtatshme, duke e përqendruar mësimdhënësi në të kuptuarin e qëllimit të shfaqjes së sjellje dhe jo në sjelljen e papërshtatshme (Dreikurs, 1975). Filozofia edukative e Dreikurs bazohet në filozofinë e demokracisë, me parimin e saj të nënkuptuar të barazisë njerëzore, dhe në qasjen socio-teologjike të psikologjisë së Alfred Adler. Adler besonte se individi dhe bota e brendshme e vetes në mënyrë vendimtare formëson identitetin dhe marrëdhëniet me të tjerët të cilat janë të rëndësishme për mirëqenien psikologjike dhe sociale. Në këtë kornizë referimi, njeriu njihet si një qenie shoqërore, veprimet e qëllimshme të drejtuara drejt një qëllimi, personaliteti i tij si një entitet unik dhe i pandarë (Dreikurs, 1968). Ai promovon përdorimin e inkurajimit dhe pasojave logjike sesa shpërblimet dhe ndëshkimet.

Shoqata e Disiplinës Pozitive zhvilloi një studim në një shkollë fillore Sacramento me të ardhura më të ulëta. Studimi tregon se gjatë periudhës katër vjeçare, pezullimet u ulën (nga 64 në 4 në vit), vendalizimi u ul (nga 24 dukuri në 2) dhe mësuesit raportuan një përmirësim të klimës në klasë, sjelljes dhe performancës akademike (Platt, 1979).

Rudolf Dreikurs (kolegu i Adler-it) zhvilloi më tej psikologjinë Adleriane për t'iu drejtuar fëmijës me qëllim të ngritjes së vetëdijes për sjelljet e gabuara. Përdorimi i kësaj qasjes ka pasur një ndikim të rëndësishëm në praktikën arsimore në klasat demokratike. Dreikurs, fokusin kryesor e kishte në ndërveprimin e sjelljeve individuale me përkatësinë shoqërore. Qasja teorike e tij ka për qëllim të kuptuarin e sjelljeve të papërshtatshme që lindin nga qëllimet e gabuara të sjelljes shoqërore dhe si të mbështeten ata në ndërgjegjësimin e tyre.

Nevoja kryesore shoqërore e fëmijëve është “të përkasin”. Kur një fëmijë hyn në shoqërinë e një shkolle dhe një klase nevoja kryesore sillet rreth asaj se si do të përshtatet, pranohen nga të tjerët veçanërisht nga moshatarët e vet (Dreikurs & Soltz, 1985). Shumë fëmijë mësojnë të bëhen pjesë e shoqërisë, mësojnë normat themelore shoqërore dhe pritjet, mësojnë të punojnë sipas rregullave dhe të bashkëpunojnë. Sidoqoftë, jo të gjithë janë kaq të hapur. Disa fëmijë shfaqen shumë tërheqës, të papërshtatshëm dhe shkatërrues. Sjelljet përçarëse, përballja dhe kërkimi i pushtetit janë sjellje që

tregojnë përpjekjen e fëmijës për të përkitur. “Individët që vuajnë nga ndjenjat të tepërta të inferioritetit nxiten nga një nocion i ekzagjeruar vlerës së tyre, i cili merr formën e një udhëzuesi të paarsyeshëm trillimi drejt të cilit ata përpiqen...”. Besimi i individit në vete “Unë meritoj”, “Unë jam i veçantë” dhe perceptimi i paarsyeshëm dhe joreal i vetes mund të çojë në egoizëm kjo që është një tipar tipik i personaliteteve narciste (Twenge & Campbell, 2009).

Adler dhe Dreikurs pohojnë se rrënjët e para të sjelljeve të gabuara lindin në dinamikën e parë shoqëri - familje. Kur prindërit janë tepër lejues, mbrojtës apo tepër dominant atëherë kjo do të ndikoj në gjendjen emocionale gjendje kjo që do të ndikon shumë në sjelljet e fëmijës. Sjelljet e papërshtatshme të një fëmije shprehen në mënyrë karakteristike dhe burojnë nga vetëvlerësimet e gabuara të tyre. Këto sjellje Dreikurs thekson se nxënësit i shprehin me qëllim që të fitojnë vëmendje, pushtet, hakmarrje dhe të reflektojnë shqetësim dhe stres për mësimdhënësin dhe bashkëmoshatarët.

Modifikimi i sjelljes ose metoda skineriane

Skinner, psikologu i njohur amerikan kishte një ndikim të madh në bihejviorizëm, i cili besonte se i gjithë veprimi njerëzor është rezultat i kushtëzimeve. Sipas metodës skineriane mësimdhënësi duhet të vendos e të sqaroj rregullat e sjelljes në klasë, të çmoj vazhdimisht nxënësit që kanë sjellje të mirë, të injorojë sa më shumë sjelljen e papërshtatshme, të përdor sa më shumë stimuj përforcues. Ai besonte se mënyra më e mirë për të kuptuar sjelljen është të shikoni shkaqet e një veprimi dhe pasojat e tij. Thelbi i kësaj metode është ndryshimi i ngjarjeve mjedisore të mundshme të cilat mund të rezultojnë në shfaqjen e një sjelljeje negative (Skinner, 1938). Sipas kësaj metode sjelljet mësohen përmes ndërveprimit me mjedisin ku faktorët e trashëguar apo të lindur kanë shumë pak ndikim në sjellje. Në teorinë e të mësuarit të sjelljes përsëritja e situatës dhe përforcimi pozitiv duhet të shkojnë paralelisht. Mësimdhënësit duhet të përsërisin situatën me qëllim që të vijnë deri tek përforcimi pozitiv për t’u treguar nxënësve pse duhet ta vazhdojnë atë sjellje (Sagal, 1981).

Motivimi luan një rol të rëndësishëm në mësimin e sjelljes. Përforcimi pozitiv dhe negativ mund të jenë motivues për nxënësit. Nxënësi që merr lëvdata për një rezultat të mirë ka shumë më

shumë gjasa të mësoj përgjigjet sesa një nxënës që nuk merr lavdërime për një rezultat të mirë. Nxënësi që nuk merr lavdërime përjeton përforsim negativ-truri u thotë se megjithëse ka marrë një notë të mirë, nuk ka shumë rëndësi, kështu që materiali i testit bëhet i parëndësishëm për të. Anasjelltas nxënësit që marrin përforsim pozitiv shohin një korrelacion të drejtpërdrejtë me përsosmërinë e vazhdueshme (Hardin, 2004).

Mësimdhënësit mund të zbatojnë teknika të strategjisë së modifikimit të sjelljes në klasën e tyre në shumë mënyra, duke përfshirë: stërvitjen, pyetje dhe përgjigje, praktikë e drejtuar, rishikim i rregullt, përforsim pozitiv .

- Stërvitje - Mësuesit mund të praktikojnë aftësitë duke përdorur modele stërvitore për t'i ndihmuar nxënësit të shohin përsëritjen dhe përforsimin që përdor teoria e të mësuarit të sjelljes.
- Pyetje dhe përgjigje - Mësuesit mund të përdorin një pyetje si stimul dhe përgjigje si përgjigje gradualisht duke e bërë më të vështirë me pyetje për të ndihmuar nxënësit.
- Praktikë e drejtuar - Mësuesit mund të përfshihen drejtpërdrejt në ndihmën e nxënësve që të kalojnë problemet për t'u dhënë atyre përforsimin dhe demonstrimin e sjelljes që dëshironi që ata të ndjekin.
- Rishikim i rregullt - Rishikimet janë të rëndësishme për këtë teori. Kthimi mbrapa mbi materialin dhe dhënia e përforsimit pozitiv do t'i ndihmojë nxënësit të mbajnë informacionin shumë më mirë.
- Përforsim pozitiv - Këto përforsime mund të jenë në formën e përforsimit dhe lavdërimit verbal, sistemeve të shpërblimit, privilegjeve të shtuara dhe më shumë.

Terapia realiste

Themeluesi i terapisë realiste është psikiatri amerikan William Glasser, i cili zbatoi teorinë e tij në çështje shoqërore duke përfshirë këtu edhe arsimin. Sipas Glasser (Glasser, Take effective control of your life, 1965) ekzistojnë pesë nevoja themelore të të gjitha qenieve njerëzore: mbijetesë, dashuria dhe përkatësia, fuqia, liria ose pavarësia dhe argëtimi e kënaqësia. Kjo terapi pohon se arsyeja kryesore që një individ shfaq sjellje jo të mira është sepse atij i mungon një qenie tjetër për t'u lidhur, ose i mungon një nevojë tjetër themelore për mbijetesë, ku nevoja më parësore

është nevoja për dashuri dhe përkatësi (Corey, 2009). Kjo metodë mbështet idenë e përmirësimit të marrëdhënieve dhe rrethanave duke shmangur diskutimin e ngjarjeve të kaluara me qëllim të kontrollimit të sjelljeve.

Terapia e realitetit mund të përdoret për të ndihmuar nxënësit me çrregullime emocionale dhe të sjelljes (Passaro, Moon, Wiest, & Wong, 2004). Një studim i zhvilluar në qytetin Daegu (Ohju, 2010) kishte për qëllim vërtetimin e efektit të programit grupor të terapisë realiste në vetëvlerësimin e sjelljes dhe përballjes së problemeve. Në këtë studim ku morën pjesë 20 nxënës të shkollave të mesme, 10 prej të cilëve ishin ata që kishin përjetuar dhunë në shkollë dhe 10 të tjerë u caktuan rastësisht në grupin eksperimental dhe në grup të kontrollit. Grupi eksperimental mori pjesë në programin grupor të mbajtur gjithsej 8 javë. Si rezultat i së cilës grupi eksperimental tregoi ndryshme të rëndësishme në vetëvlerësimin e sjelljes dhe përballimit të problemit krahas grupit të kontrollit. Rezultatet e këtij studimi theksojnë rëndësinë e përdorimit të programit grupor të terapisë realiste në përmirësimin e vetëvlerësimit dhe aftësisë për përballje të problemeve.

Kjo terapi përdoret për të udhëhequr nxënësit që të bëhen individ të përgjegjshëm të cilët do të jenë në gjendje të kënaqin nevojat e tyre për të mirën e tyre dhe të tjerëve. Pavarësisht kohës, kjo qasje i ka rezistuar kohës dhe është në përdorim edhe sot.

Mësuesit supozohet të ndihmojnë nxënësve të bëjnë zgjedhjet e duhura, duke iu shmangur zgjedhjeve të gabuara. Nëse ata zgjedhin sjelljen e gabuar, mësuesit dhe nxënësit duhet të punojnë së bashku për të vlerësuar sjelljen e gabuar dhe pastaj duhet të hartojnë një plan të zbatueshëm për nxënësit që të bëjnë ndryshime.

Kjo qasje vëren se stilet e ndryshme të prindërimit nuk duhet të jenë arsytet e pranueshme për sjellje. Kur nxënësit shfaqin sjellje të papërshtatshme, mësuesit duhet të pyet se çfarë po bëjnë në vend që t'i pyesni ata për arsye, sepse nxënësve duhet t'u besohet që të analizojnë sjelljen e tyre dhe të korrigjojnë sjelljet e papërshtatshme të tyre (Mathew, 2016).

Megjithëse qeniet njerëzore ndikohen nga mjedisi i tyre dhe marrëdhëniet e tyre të mëparshme, ata zgjedhin shumicën e veprimeve të tyre. Përmes zbatimit të terapisë së realitetit

nxënësit lirohen dhe ndihmohen për të bërë zgjedhje realiste për të kënaqur në mënyrë më efektive nevojat e tyre brenda kufizimeve (Wubbolding, 2015).

Meqenëse besimi dhe përgjegjësia janë komponentët thelbësor të qasjes së vetë-disiplinës, mësuesit dhe nxënësit duhet të jenë në gjendje të komunikojnë pa pengesa. Glasser (Glasser, 1985) ka pohuar se mësuesi mbanë çelësin e disiplinës së mirë, ku për të arritur këtë disiplinë përgjegjësitë që mban mësuesi janë:

- Vendosja e rregullave të klasës që çojnë në sukses. Rregullat duhet të formulohen bashkë me nxënësit gjithmonë duke përforcuar pikën se nxënësit janë në shkollë për të mësuar.
- Mësuesit nuk duhet të pranojnë asnjë justifikim kur nxënësit nuk arrijnë të përmbushin angazhimet që kanë marrë.
- Duhet të jenë këmbëngulës për vendosjen e rregullave dhe respektimit të tyre.
- Rishikimi i vazhdueshëm i sistemit të disiplinës sipas nevojës, përmes takimeve në klasë. Këto takime nuk do të bëhen me qëllim të gjetjes së gabimit por gjetjes së zgjidhjes

Nxitja e gjykimit të vlerës. Kur nxënësit sillen keq, ata duhet të gjykojnë veten dhe të tjerët. Mësuesit këshillohen të flasin me nxënësin që nuk sillet mirë në një kohë të përshtatshme brenda ditës. Nëse mësuesit mund të bëjnë të kuptojnë rëndësinë e mirësjelljes asnjë rregull tjetër nuk mund të jetë i nevojshëm (Glasser, 1969).

Vetëkontrolli i sjelljes

Gordoni, themeluesi i kësaj metode është fokusuar në mënyrën se si mund të zgjidhen sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në mënyrë që të përmirësohen marrëdhëniet e tyre e mësimdhënësin apo edhe me bashkëmoshatarët e tyre. Si funksion ekzekutiv, vetëkontrolli është një proces njohës që është i domosdoshëm për rregullimin e sjelljes me qëllim të arritjes së qëllimeve specifike. Sjelljet e fëmijëve, janë të përcaktuara nga sjellja e rriturve dhe vetë ajo që gërshetohet në atë që e quajnë sjellje me domethënie të ndryshme, varësisht se nga kush vështrohet (Gordon & Brunch, 2003). Fokusi kryesor i Thomos Gordonit për sukses në menaxhimin e klasës sillet rreth idesë për të ndihmuar nxënësit të kenë vetëbesim. Ai i nxit mësuesit të shmangin metodat që përfshijnë detyrimin, shpërblimin ose ndëshkimin. Gordon në klasë përfshin përdorimin e dëgjimit

aktiv si një strategji për komunikim në mes nxënësve dhe mësuesit. Kjo strategji përdoret për ti dhënë nxënësit një mundësi për të shprehur ndjenjat e tij me dijeninë se mësuesi do të kuptoj dhe pranoj atë që ndjen dhe thotë. Zgjidhja e problemeve mund të bëhet më e lehtë kur përcaktohen nevojat e mësuesit dhe nxënësit, vihen idetë për zgjidhje, vlerësohen zgjidhjet, zgjidhen zgjidhjet dhe së fundmi bëhet zbatimi i zgjidhjes dhe kontrollimi i rezultateve (Gordon, 1991).

Kjo metodë mbi menaxhimin kërkon që studentët të marrin pjesë aktive në vendime lidhje me mësimin e tyre. Nxënësit dhe mësuesit punojnë së bashku për të përcaktuar mësimet, për të krijuar klasën dhe për të zgjedhur metodat e të mësuarit. Kjo metodë ndërveprues e disiplinës është një mënyrë produktive për t'u mësuar fëmijëve përgjegjësinë dhe llogaridhënien. Asnjë disiplinë nuk mund të ekzistojë nëse nuk ka komunikim efektiv.

Një pjesë e rëndësishme e teorive të Gordonit mbi disiplinën dhe menaxhimin e klasës është mënyra se si mësuesit reagojnë ndaj situatave problematike të sjelljeve. Në vend se ata t'iu drejtohen nxënësve dhe ti gjykojnë për sjelljet e papërshtatshme të tyre më produktive do të ishte që ata të shprehin ndjenjat se si ndjehen dhe ndikohen personalisht nga sjellja e papërshtatshme të sjelljeve të nxënësve, përmes kësaj metode nxënësit inkurajohen për vetë kontroll të sjelljes, shmangies së përsëritjes së situatës dhe respektimit të disiplinës (Charles & Senter, 2004).

Disiplina me dinjitet ose kontrata sociale

Modeli i disiplinës me dinjitet përfaqësohet nga edukatorët dhe autorët amerikan Richard Curwin dhe Allen Mendler. Sipas tyre kontrata sociale paraqet një mori rregullash dhe pasojash të cilat mbajnë nën kontroll sjelljen e nxënësve në klasë. Pra, rregullat dhe pasojat diskutohen në klasë dhe kur arrihet marrëveshja ato duhet të zbatohen me përpikëri. Kjo kontratë siguron qartësi të rregullave, përfshirë pasoja dhe jo dënime, të lejojë ndryshimin me nevojat e klasës, të ketë masa mbrojtëse për të mbrojtur dinjitetin e nxënësve dhe për të rritur komunikimin (Curwin & Mendler, 2018).

Disiplina me dinjitet përfshin tre dimensione: parandalimin, veprimin dhe zgjidhjen. Filozofia e kësaj metode qëndron në ngritjen e dinjitetit të nxënësve duke u nisur nga parime se çdo

qenie njërzore meriton respekt dhe dinjetet. Në këtë qasje, mësimdhënësit duhet të besojnë se përgjegjësia është më e rëndësishme sesa bindja tek nxënësit dhe nxënësit gjithmonë duhet të trajtohen me dinjitet dhe respekt. Kontrata sociale paraqet një mori rregullash dhe pasojash të cilat mbajnë nën kontroll sjelljen e nxënësve në klasë. Pra, rregulla dhe pasojat diskutohen në klasë dhe kur arrihet marrëveshja ato duhet të zbatohen me përpikëri. Kjo kontratë siguron qartësi të rregullave, përfshirë pasoja dhe jo dënime, të lejojë ndryshimin me nevojat e klasës, të ketë masa mbrojtëse për të mbrojtur dinjitetin e nxënësve dhe për të rritur komunikimin (Curwin & Mendler, 2018).

Kjo disiplinë rekomandon që mësimdhënësit të jenë konsistentë në zbatimin e pasojave, ata duhet të deklarojnë pasojën kur rregulla thyhet, të qëndrojnë pranë nxënësit kur zbatojnë një pasojë, të bëjnë kontakt të drejtpërdrejtë me sy, të përdorin një zë të butë, duhet të shmangët turpi i nxënësit para klasës dhe më e rëndësishmja mësuesit duhet të jenë të vendosur në atë që ndërmarrin, të refuzojnë justifikime ose ankesa dhe të jenë të lirë nga zemërimi kur zbatojnë pasojën.

Efektiviteti i kësaj qasje zvogëlohet në qoftë se nxënësit kundërshtojnë dhe refuzojnë kontratën. Ekziston një marrëdhënie e bazuar në respekt reciprok në mes nxënësve dhe mësuesit. Respekti reciprok dhe pasojat e qëndrueshme zvogëlojnë luftën për pushtet dhe rrisin mundësitë që nxënësit të angazhohen në mësim. Modeli i disiplinës me dinjitet është një model fleksibël që përshtat idetë si nga studentët ashtu edhe nga mësuesit. Ky model integron në vete parashikimin, dëgjimin aktiv, pasojat logjike, afërsinë dhe analizën e sjelljes.

Faktorët që ndikojnë në klimën pozitive në klasë

Për një mësimdhënie efektive kërkohet planifikim dhe qëndrueshmëri nga mësimdhënësi. Kern dhe Clemens kanë identifikuar faktorët që kontribuojnë në rezultate pozitive gjatë punës me nxënësit. Ata theksuan se: rregullat të thjeshta dhe të qarta, parashikueshmëria e ngjarjeve dhe aktiviteteve, përdorimi i shpeshtë i lëvdatave verbale dhe joverbale, monitorimi i vështirësive, përzgjedhja dhe renditja e aktiviteteve, ritmi i mësimin si dhe përfshirja në aktivitete mësimore ndikojnë në një mësimdhënie efektive dhe të qëndrueshme (Kern & Clemens, 2007).

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me nxënësit është një strategji e rëndësishme që mund t'i shërbejë apo ta zvogëlojë sjelljen e papërshtatshme dhe përmirësojë arritjet e nxënësve (Sutherland, Lewis-Palmer, Stichter, & Morgan, 2008). Këtë definim e plotëson edhe më shumë artikulli hulumtues (Allday & Pakurar, 2007) të cilët gjetën se te tre nxënësit të moshës 12-14 vjeç,

përshëndetjet e mësuesit në derën e klasës duke iu drejtuar atyre me emër dhe duke përcjell një koment pozitiv ishin të mjaftueshme për të ndikuar pozitivisht në ndryshimin e sjelljes së tyre nga 45% në 75% në një kohë relativisht të shkurtër.

Alderman dhe Green (Alderman & Green, 2011) kanë identifikuar dhe përshkruar disa strategji që mësimit mund të përdorin për të përmirësuar marrëdhëniet me nxënësit dhe për të vënë kontroll në klasë. Ato janë:

- Fuqia shtrënguese: E cila përfshin përdorimin e arsyeshëm të autoritetit nga ana e mësimit për të arritur ndryshim në sjellje të nxënësit.
- Fuqia manipuluese sociale: Mësimit vetë-monitoron, jep zgjidhje për përfundimin e detyrave, prezanton aktivitete interesante për të motivuar nxënësit.
- Fuqia sociale: Përfshin ofrimin e mbështetjes akademike që ndihmon nxënësit të kapërcejnë problemet që ata nuk mund t'i zgjedhin vetë. humori, ngrohtësia
- Fuqia e brendshme: bazohet në përdorimin e karakteristikave të personalitetit si entuziazmi, humori, ngrohtësia për të nxitur sjellje pozitive tek nxënësit.

Një studim i realizuar në Izmir kishte për qëllim vlerësimin e efektit të Programit të trajnimit të menaxhimit të klasës. Për këtë studim ishin zgjedhur tridhjetë mësimit të cilët u ndanë në grupe të kontrollit dhe grupe eksperimentale. Mësimit të grupit eksperimental ndoqën Programin e trajnimit të menaxhimit të klasës, si rezultat si së cilës u ndjenë më të sigurt nga vetja gjatë paraqitjes së sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve pasi ishin shumë fleksibël në trajtimin e tyre krahasim me mësimit të grupit të kontrollit. Mësuesit u shprehën se preferonin të përdonin më shumë qasjen parandaluese në vend të qasjes kufizuese për të përballuar me sjelljet e papërshtatshme (Guzledere-Aydin & Ocak-Karabay, 2020).

Në bazë të hulumtimit të kryer nga (Zabeli, 2008) me tetë mësimit të klasave I-IV, i cili në qasjen metodologjike përdori: eksperimentin në klasë, anketimin me mësimit, fokus grupin dhe intervistimin. Nga studimi i tij është vërtetuar se teknikat ndërvepruese të mësimit ndikojnë në reduktimin e sjelljeve të papërshtatshme, ku përgjigjet e mësimit të cilët shfrytëzojnë kohën për reduktimin e sjelljeve të papërshtatshme ishin kështu: 35.01% shfrytëzojnë gjithnjë, 42.80% shfrytëzojnë shpeshherë, 16.34% shfrytëzojnë ndonjëherë, 3.89% shfrytëzojnë pak herë, ndërsa 1.94% nuk shfrytëzojnë fare.

Të gjitha studimet dhe literatura përforcojnë faktin se krijimi i marrëdhënieve pozitive me të gjithë nxënësit në klasë paraqet një akt parandalues apo zvogëlues i sfidave dhe sjelljeve përçarëse ku mësimdhënësit duke mbështetur dhe inkurajuar sjelljet pozitive bëhen edhe menaxherë efektiv të klasës. Parandalimi, identifikimi i hershëm dhe trajtimi i sjelljes përçarëse mund të përmirësojë rezultatet.

III. METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të vërtetohet se në çfarë mase janë të përhapura sjelljet e papërshtatshme në klasat tona, si ndikojnë këto sjelljet në arritjet akademike të nxënësve, me çfarë sfida mësimdhënësit përballen dhe çfarë metoda përdorin për zvogëlimin dhe shmangien e këtyre sjelljeve. Për t'i arritur këto qëllime, në hulumtimin tonë është përdorur metoda kuantitative, ku përmes instrumentit të pyetësorit kemi mbledhur të dhënat sasiore parësore nga mostra e përzgjedhur.

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë institucionet edukativo-arsimore të ciklit të ulët (I-V), nga sektori publik të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në Komunën e Prizrenit. Në fokus të analizës janë zgjedhur katërmëdhjetë institucione edukativo-arsimore të ciklit të ulët, nga sektori publik, të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në këtë komunë.

Pjesëmarrësit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në këtë hulumtim, i janë nënshtruar pyetësorit, i cili përbëhet prej pyetjeve të tipit të mbyllur, të formuluar në përputhje të plotë për të iu shërbyer qëllimeve, pyetjeve hulumtuese dhe hipotezave të këtij punimit. Të dhënat e mbledhura janë analizuar me metoda statistikore.

Me një karakter përshkrues ky hulumtim pasqyron gjendjen aktuale me të cilën ballafaqohen mësimdhënësit me sjellje të papërshtatshme të nxënësve gjatë përvojës së tyre.

Mostra

Pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin pikërisht mësimdhënësit e 14 shkollave fillore të regjionit të Prizrenit të vendeve urbane dhe rurale. Shkollat pjesëmarrëse ishin: “Mustafa Bakiu”, “Fadil Hisari”, “Abdyl Frashëri”, “Emin Duraku”, “Mati Logoreci”, “Lekë Dukagjini”, “Lidhja e Prizrenit”, “Naim Frashëri” - Vlashnjë, “Hasim Maliqaj” - Poslishtë, “Ekrem Rexha Drini” - Lubizhdë, “Dëshmorët e Vrrinit” - Billushë, “Besim Ndrecaj” - Lutogllavë, “Haziz Tola”, si dhe “Dëshmorët e Zhurit” - Zhur.

Gjithsej pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin 150 mësimdhënës, ndërsa faktorët demografikë dhe social ishin sipas mostrës së rastësishme. Në tabelën 1 është paraqitur numri i pjesëmarrësve në hulumtim sipas shkollave.

Tabela 1. Numri i pjesëmarrësve në hulumtim sipas shkollave

Shkolla ku punoni	N
“Mustafa Bakiu”	7
“Fadil Hisari”	20
“Abdyl Frashëri”	8
“Emin Duraku”	24
“Mati Logoreci”	8
“Lekë Dukagjini”	9
“Lidhja e Prizrenit”	7
“Naim Frashëri” – Vlashnje	12
“Hasim Maliqaj” – Poslisht	12
“Ekrem Rexha Drini” – Lubizhdë	13
“Dëshmorët e Vrrinit” – Billushë	7
“Besim Ndrecaj” - Lutogllavë	9
“Haziz Tola”	7
“Dëshmorët e Zhurit” – Zhur	7
Gjithsej	150

Instrumentet

Instrumenti i hulumtimit ka gjithsej 23 pyetje së bashku me pyetjet demografike. Duke ditur që pyetëtori nuk përmbanë shkallë të matjes nga autorët e tjerë pasi që është përpiluar vetëm për qëllimet e këtij hulumtimi, kështu para se të fillonte anketimi i pjesëmarrësve, është aplikuar një pilot-pyetësor në shkollën Sh.F.M.U “Hasim Maliqaj”, me kolgët e mi të punës, me qëllim që të evidentohen mangësitë dhe paqartësitë lidhur me pyetjet dhe të formulohet një instrument i qëlluar për realizimin e hulumtimit.

Në pjesën e parë të pyetësorit janë të paraqitura pyetjet demografike si (emri i institucionit, vendi i shkollës, gjinia, moshë, niveli i shkollimit, përvoja e punës).

Në pjesën e dytë janë trajtuar pyetjet që prekin saktësisht sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.

Në pjesën tretë pyetjet që prekin metodat e trajtimit të sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve dhe sfidat me të cilat ata hasin.

Pyetjet i takojnë tipit të mbyllur me mundësi të zgjedhjes së përgjigjeve nga *nuk pajtohem aspak* deri në *pajtohem plotësisht*.

Procedurat

Pas zgjedhjes së temës dhe caktimit të metodologjisë së punimit është vazhduar puna në teren. Duke pasur parasysh që pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin mësimdhënësit atëherë puna e parë ishte marrja e lejes nga Drejtoria Komonale e Arsimit, e cila mundësoi realizimin e hulumtimit në shkollat përkatëse. Kërkesës së lejes për hulumtim ia kam bashkangjitur qëllimin e hulumtimit dhe instrumentin hulumtues. Aprovimi nga DKA-ja erdh brenda një periudhe të shkurtër kohore me përgjigje pozitive.

Mbledhja e të dhënave u realizua gjatë muajit dhjetor të vitit 2020 dhe zgjati gjithsej një muaj. Pyetësorët janë shpërndarë përmes kopjes fizike në çdo shkollë të zgjedhur. Në momentin e shpërndarjes së pyetësorëve fillimisht i kam dhënë informatat kryesore rreth hulumtimit dhe pyetësorit të mësimdhënësve. Gjatë plotësimit të tyre nuk kam qenë e pranishme me qëllim që të mos i jap presion mësimdhënësve dhe të mos ndikoj në rrjedhën e rezultateve. Pasi është realizuar puna në teren, të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe analizuar përmes programit SPSS dhe janë paraqitur në mënyrë statistikore.

Duke u bazuar në rezultatet e fituara formuluar konkludimet dhe rekomandimet e

nevojshme ndaj organeve përgjegjëse me qëllim të përmirësimit të qasjes ndaj situatave të tilla shqetësuese.

IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Në këtë kapitull është shtjelluar analiza e të dhënave të mbledhura nga hulumtimi i realizuar. Të dhënat kuantitative janë analizuar përmes metodave statistikore ku kemi aplikuar programin SPSSv.25. Analiza e të dhënave është bërë në bazë të renditjes së pyetjeve në pyetësor, duke filluar nga pyetjet demografike të pjesëmarrësve, për të vazhduar më tej me pyetjet specifike të cilat ndërlidhen me çështjen e trajtuar.

Për vërtetimin e hipotezave janë aplikuar dy lloje të testeve, analiza faktoriale përmes së cilës kemi analizuar hipotezën se parë, respektivisht nëse sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura shumë në klasa, ndërsa përmes testit H_i^2 kemi analizuar hipotezën e dytë, gjegjësisht nëse mësimdhënësit sfidohen shumë nga sjelljet e papërshtatshme si dhe hipotezën e tretë nëse mësuesit përdorin llojllojshmëri metodash për menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme në procesin mësimor. Të gjitha rezultatet janë paraqitur në tabela dhe figura perkatëse. Niveli i margjinës së gabimit e cila është përdorur për të vërtetuar hipotezat është 0.01 dhe 0.05.

Rezultatet deskriptive

Siç shihet nga tabela 2, në hulumtim morën pjesë gjithsej 150 mësimdhënës nga gjithsej 14 shkolla të komunës së Prizrenit, nga të cilët nga institucioni SHFMU “Mustafa Bakiu” janë 4.7 % e pjesëmarrësve, nga SHFMU “Fadil Hisari” janë 13.3%, nga SHFMU “Abdyl Frashëri” janë 5.3% e pjesëmarrësve, nga SHFMU “Emin Duraku” janë 16%, nga SHFMU “Mati Logoreci” janë 5.3% e pjesëmarrësve, nga SHFMU “Lekë Dukagjini” janë 6%, nga SHFMU “Lidhja e Prizrenit” janë 4.7% e pjesëmarrësve, nga SHFMU “Naim Frashëri” janë 8% e mësimdhënësve, nga SHFMU “Hasim Maliqaj” janë 8%, nga SHFMU “Ekrem Rexha Drini” janë 8.7% e mësimdhënësve, nga SHFMU “Dëshmorët e Vërrinit” janë 4.7% e pjesëmarrësve dhe nga SHFMU “Besim Ndrecaj” janë 6% , nga SHFMU “Haziz Tola” janë 4.7% e pjesëmarrësve, si dhe nga SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” janë 4.7% e pjesëmarrësve.

Tabela 2. Institucionet e punës së mesimdhënësve

Shkolla ku punoni	N	%
“Mustafa Bakiu”	7	4.7
“Fadil Hisari”	20	13.3
“Abdyl Frashëri”	8	5.3
“Emin Duraku”	24	16.0
“Mati Logoreci”	8	5.3
“Lekë Dukagjini”	9	6.0
“Lidhja e Prizrenit”	7	4.7
“Naim Frashëri” – Vlashnje	12	8.0
“Hasim Maliqaj” – Poslisht	12	8.0
“Ekrem Rexha Drini” – Lubizhdë	13	8.7
“Dëshmorët e Vrrinit” – Billushë	7	4.7
“Besim Ndrecaj” – Lutogllavë	9	6.0
“Haziz Tola”	7	4.7
“Dëshmorët e Zhurit” – Zhur	7	4.7

Në tabelën 3, janë paraqitur pjesëmarrësit sipas vendit në të cilat gjenden institucionet edukativo-arsimore ku ata punojnë. Në këtë hulumtim, 36% e pjesëmarrësve janë nga lokacioni rural, kurse 64% e pjesëmarrësve nga lokacioni urban. Shkollat janë zgjedhur në mënyrë të qëllimshme, 6 shkolla të rajonit rural dhe 8 shkolla të rajonit urban.

Tabela 3. Vendi i punës së mësimdhënësve

Vendi i shkollës	N	%
Fshat	54	36.0
Qytet	96	64.0

Sa i përket gjinisë së mësimdhënësve, prej tyre 114 ishin të gjinisë femërore apo 76% dhe 36 të gjinisë mashkullore apo 24% prej tyre (shih tabelën 4).

Tabela 4. Gjinia e mësimdhënësve

Gjinia	N	%
Femër	114	76.0
Mashkull	36	24.0

Në tabelën e 5 është paraqitur grupmosha e pjesëmarrësve në hulumtim, nga ku shohim se 22 prej mësimdhënësve i takojnë grupmoshës 22-30 vjeç apo 14.7%, 42 mësimdhënës i takojnë grupmoshës 31-40 vjeç apo 28%, 36 mësimdhënës i takojnë grupmoshës 41-50 vjeç apo 24% dhe 50 mësimdhënës grupmoshës mbi 50 vjeç apo 33.3%.

Tabela 5. Grupmosha e mësimeve në hulumtim

Grupmosha	N	%
22- 30 vjeç	22	14.7
31-40 vjeç	42	28.0
41- 50 vjeç	36	24.0
Mbi 50 vjeç	50	33.3

Më poshtë, në tabelën 6, janë paraqitur rezultatet në lidhje me nivelin e shkollimit të pjesëmarrësve në hulumtim. Rezultatet tregojnë se 6.7% prej tyre janë me përgatitjen profesionale të Shkollës së lartë, 74% prej tyre me përgatitjen profesionale Bachelor, 15.3% prej tyre me përgatitjen profesionale Master dhe 4% prej tyre me përgatitjen profesionale Doktoratë.

Tabela 6. Niveli i shkollimit

Niveli i shkollimit	N	%
Shkolla e lartë	10	6.7
Bachelor	111	74.0
Master	23	15.3
Doktoratë	6	4.0

Në tabelën 7, kemi rezultatet lidhur me përvojë të punës, nga ku shohim se me 1-3 vite janë 22 mësimdhënës apo 14.7%, 13 me përvojë në mes 4-6 vite apo 8.7%, 29 me përvojë në mes 7-10 vite apo 19.3%, si dhe 85 mësimdhënës me përvojë më shumë se 10 vite apo 56.7%.

Tabela 7. Përvoja e punës

Përvoja e punës	N	%
1-3 vite	22	14.7
4-6 vite	13	8.7
7-10 vite	29	19.3
Më shumë se 10 vite	85	56.7

Në deklaratën “Mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona” (shih tabelën 8), shohim se 25 pajtohen plotësisht apo 16.7%, 33 pajtohem pjesërisht apo 22%, mesatarisht janë 35 apo 23.3%, 32 nuk pajtohen pjesërisht apo 21.3% dhe 25 nuk pajtohen aspak apo 16.7%.

Tabela 8. Përhapja e sjelljeve të papërshtatshme

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	25	16.7	16.7	16.7
Pajtohem pjesërisht	33	22.0	22.0	38.7
Mesatarisht	35	23.3	23.3	62.0
Nuk pajtohem pjesërisht	32	21.3	21.3	83.3
Nuk pajtohem aspak	25	16.7	16.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Siç shihet nga të dhënat e tabelës 9, të pyetur për deklaratën “Sfidohehem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë” mësimdhënësit dhanë këto përgjigje: 18 pajtohen plotësisht apo 12%, 21 pajtohen pjesërisht apo 14%, mesatarisht janë 41 apo 27.3%, 33 nuk pajtohen pjesërisht apo 22% dhe nuk pajtohen aspak janë 37 apo 24.7%.

Tabela 9. Sfida e mësimdhënësve me sjelljet të papërshtatshme të nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	18	12.0	12.0	12.0
	Pajtohem pjesërisht	21	14.0	14.0	26.0
	Mesatarisht	41	27.3	27.3	53.3
	Nuk pajtohem pjesërisht	33	22.0	22.0	75.3
	Nuk pajtohem aspak	37	24.7	24.7	100.0
Total		150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e dhëna” (tabela 10), 16 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 19.7%, 31 pajtohen pjesërisht apo 20.7%, mesatarisht janë 35 apo 23.3%, 35 nuk pajtohen pjesërisht apo 23.3% dhe 33 nuk pajtohen aspak apo 22%.

Tabela 10. Nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e dhëna

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	16	10.7	10.7	10.7
	Pajtohem pjesërisht	31	20.7	20.7	31.3
	Mesatarisht	35	23.3	23.3	54.7
	Nuk pajtohem pjesërisht	35	23.3	23.3	78.0
	Nuk pajtohem aspak	33	22.0	22.0	100.0
Total		150	100.0	100.0	

Një pjesë e madhe e mësimdhënësve (tabela 11), pajtohen me deklaratën “Nxënësit në klasë flasin pa leje”, pra kemi 23 apo 15.3% të mostrës, 28 thonë se kjo ndodh pjesërisht apo 18.7%, 21 thonë se kjo ndodh mesatarisht apo 14%, pjesërisht nuk pajtohen janë 33 apo 22% dhe 44 nuk pajtohen aspak apo 29.3%.

Tabela 11. Nxënësit në klasë flasin pa leje

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	23	15.3	15.3	15.3
	Pajtohem pjesërisht	28	18.7	18.7	34.0
	Mesatarisht	21	14.0	14.0	48.0
	Nuk pajtohem pjesërisht	33	22.0	22.0	70.0
	Nuk pajtohem aspak	44	29.3	29.3	99.3
	Total	150	100.0	100.0	

Nga tabela 12 e rezultateve e deklaratës “Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare”, 10 prej tyre pajtohen plotësisht apo 6.7%, 18 thonë se janë pjesërisht apo 12%, mesatarisht pajtohen 18 apo 12%, 38 mësimdhënës nuk pajtohen pjesërisht apo 25.3% dhe 66 prej tyre nuk pajtohen aspak apo 44%.

Tabela 12. Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	10	6.7	6.7	6.7
	Pajtohem pjesërisht	18	12.0	12.0	18.7
	Mesatarisht	18	12.0	12.0	30.7
	Nuk pajtohem pjesërisht	38	25.3	25.3	56.0
	Nuk pajtohem aspak	66	44.0	44.0	100.0
	Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin” shohim se 17 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 11.3%, 20 pajtohen pjesërisht apo 13.3%, mesatarisht 16.7%, 45 nuk pajtohen pjesërisht apo 30% dhe 43 nuk pajtohen aspak apo 28.7% (shih tabelën 13).

Tabela 13. Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	17	11.3	11.3	11.3
Pajtohem pjesërisht	20	13.3	13.3	24.7
Mesatarisht	25	16.7	16.7	41.3
Nuk pajtohem pjesërisht	45	30.0	30.0	71.3
Nuk pajtohem aspak	43	28.7	28.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Në deklaratën “Gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë”, siç shihet edhe në tabelën 14, 19 prej mësimdhënësve pajtohen plotësisht se gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë apo 12.7%, 14 pajtohen pjesërisht apo 9.3%, mesatarisht 24 apo 16%, 38 nuk pajtohen pjesërisht apo 25.3% dhe 55 të tjerë nuk pajtohen aspak apo 36.7%.

Tabela 14. Opinionet e mësimdhënësve lidhur me zhurmën e krijuar në klasë

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	19	12.7	12.7	12.7
Pajtohem pjesërisht	14	9.3	9.3	22.0
Mesatarisht	24	16.0	16.0	38.0
Nuk pajtohem pjesërisht	38	25.3	25.3	63.3
Nuk pajtohem aspak	55	36.7	36.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë”, 75 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 50%, 28 pajtohen pjesërisht apo 18.7%, mesatarisht janë 13 apo 8.7%, nuk pajtohen pjesërisht 18 apo 12% dhe nuk pajtohen aspak 16 apo 10.7%.

Tabela 15. I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	75	50.0	50.0	50.0
Pajtohem pjesërisht	28	18.7	18.7	68.7
Mesatarisht	13	8.7	8.7	77.3
Nuk pajtohem pjesërisht	18	12.0	12.0	89.3
Nuk pajtohem aspak	16	10.7	10.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Në tabelën e mëposhtme të deklaratës “Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre” kuptojmë se 92 prej mësimdhënësve pajtohen se zakonisht ulen dhe diskutojnë me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre, 22 prej tyre pajtohen pjesërisht apo 14.7%, mesatarisht 12 apo 8%, 6 nuk pajtohen pjesërisht apo 4% dhe 18 nuk pajtohen aspak apo 12%.

Tabela 16. Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	92	61.3	61.3	61.3
Pajtohem pjesërisht	22	14.7	14.7	76.0
Mesatarisht	12	8.0	8.0	84.0
Nuk pajtohem pjesërisht	6	4.0	4.0	88.0
Nuk pajtohem aspak	18	12.0	12.0	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Injoroj sjelljen e papërshtatshme të nxënësve”, nga tabela 17, shohim se 37 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 24.7%, 21 pajtohen pjesërisht apo 14%, 21 mesatarisht apo 14%, 19 nuk pajtohen pjesërisht apo 12.7% dhe 51 nuk pajtohen aspak apo 34% e mësimdhënësve.

Tabela 17. Injoroj sjelljen e papërshtatshme të nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	37	24.7	24.8	24.8
	Pajtohem pjesërisht	21	14.0	14.1	38.9
	Mesatarisht	21	14.0	14.1	53.0
	Nuk pajtohem pjesërisht	19	12.7	12.8	65.8
	Nuk pajtohem aspak	51	34.0	34.2	100.0
	Total	150	100.0	100.	

Nga tabela 18 e rezultateve e deklaratës “Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme”, 27 mësimdhënës thonë se pajtohen pjesërisht apo 18% e tyre, mesatarisht janë 26 apo 17.3%, 11 nuk pajtohen pjesërisht apo 7.3% dhe 21 nuk pajtohen aspak apo 14%.

Tabela 18. Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	65	43.3	43.3	43.3
	Pajtohem pjesërisht	27	18.0	18.0	61.3
	Mesatarisht	26	17.3	17.3	78.7
	Nuk pajtohem pjesërisht	11	7.3	7.3	86.0
	Nuk pajtohem aspak	21	14.0	14.0	100.0
	Total	150	100.0	100.0	

Në deklaratën “Fokusohem vetëm në veprimet e papërshtatshme të nxënësve”, shohim se 33 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 22%, 27 pajtohen pjesërisht apo 18%, mesatarisht 24 apo 16%, nuk pajtohen pjesërisht 20 apo 13.3% dhe 46 nuk pajtohen aspak apo 30.7%.

Tabela 19. Fokusohem vetëm në veprimet e papërshtatshme të nxënësve

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	33	22.0	22.0	22.0
Pajtohem pjesërisht	27	18.0	18.0	40.0
Mesatarisht	24	16.0	16.0	56.0
Nuk pajtohem pjesërisht	20	13.3	13.3	69.3
Nuk pajtohem aspak	46	30.7	30.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës”, 93 mësimdhënës pohojnë se vendosin rregullat në klasë bashkë me nxënësit, 25 pajtohen pjesërisht apo 16.7%, mesatarisht 9 apo 6%, 10 nuk pajtohen pjesërisht apo 6.7% dhe 11 nuk pajtohen aspak apo 7.3%.

Tabela 20. Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	93	62.0	62.0	62.0
Pajtohem pjesërisht	25	16.7	16.7	78.7
Mesatarisht	9	6.0	6.0	84.7
Nuk pajtohem pjesërisht	10	6.7	6.7	91.3
Nuk pajtohem aspak	11	7.3	7.3	98.7
Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket “Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme”, shihet se 76 pajtohen plotësisht apo 50.7%, 31 pajtohen pjesërisht apo 20.7%, mesatarisht 13 apo 8.7%, nuk pajtohen pjesërisht 16 apo 10.7% dhe 13 nuk pajtohen aspak apo 8.7%.

Tabela 21. Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	76	50.7	50.7	50.7
Pajtohem pjesërisht	31	20.7	20.7	71.3
Mesatarisht	13	8.7	8.7	80.0
Nuk pajtohem pjesërisht	16	10.7	10.7	90.7
Nuk pajtohem aspak	13	8.7	8.7	99.3
Total	150	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre”, 78 prej tyre apo 52% e mësimdhënësve pajtohen plotësisht, 31 pajtohen pjesërisht apo 20.7%, mesatarisht 11 apo 7.3%, nuk pajtohen pjesërisht 11 apo 7.3% dhe nuk pajtohen aspak 19 apo 12.7%.

Tabela 22. Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	78	52.0	52.0	52.0
Pajtohem pjesërisht	31	20.7	20.7	72.7
Mesatarisht	11	7.3	7.3	80.0
Nuk pajtohem pjesërisht	11	7.3	7.3	87.3
Nuk pajtohem aspak	19	12.7	12.7	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë”, shohim se 67 prej mësimdhënësve pajtohen plotësisht apo 44.7%, 34 pajtohen pjesërisht apo 22.7%, mesatarisht janë 19 apo 12.7%, 15 nuk pajtohen pjesërisht apo 10% dhe 15 të tjerë nuk pajtohen aspak apo 10%.

Tabela 23. Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	67	44.7	44.7	44.7
	Pajtohem pjesërisht	34	22.7	22.7	67.3
	Mesatarisht	19	12.7	12.7	80.0
	Nuk pajtohem pjesërisht	15	10.0	10.0	90.0
	Nuk pajtohem aspak	15	10.0	10.0	100.0
	Total	150	100.0	100.0	

Nga tabela e rezultateve e deklaratës “Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve”, kuptojmë se 42 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 28%, 38 pajtohen pjesërisht apo 25.3%, mesatarisht 35 apo 23.3%, nuk pajtohen pjesërisht 12 apo 8% dhe 23 nuk pajtohen aspak 15.3%.

Tabela 24. Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	42	28.0	28.0	28.0
	Pajtohem pjesërisht	38	25.3	25.3	53.3
	Mesatarisht	35	23.3	23.3	76.7
	Nuk pajtohem pjesërisht	12	8.0	8.0	84.7
	Nuk pajtohem aspak	23	15.3	15.3	100.0
	Total	150	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Shfrytëzoj kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese”, shohim se 65 mësimdhënës pajtohen plotësisht apo 43.3%, pajtohen pjesërisht 43 apo 28.7%, mesatarisht janë 14 apo 9.3%, nuk pajtohen pjesërisht janë 8 apo 5.3% dhe nuk pajtohen aspak janë 20 apo 13.3%.

Tabela 25. Përdorimi i strategjive parandaluese për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	65	43.3	43.3	43.3
Pajtohem pjesërisht	43	28.7	28.7	72.0
Mesatarisht	14	9.3	9.3	81.3
Nuk pajtohem pjesërisht	8	5.3	5.3	86.7
Nuk pajtohem aspak	20	13.3	13.3	100.0
Total	150	100.0	100.0	

Në bazë të rezultateve të hulumtimit shohim se mësimdhënësit kanë opinione relativisht të njëjta në lidhje me sjelljet e nxënësve. Ata e konsiderojnë se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat e tyre dhe kjo përqindje shkon mbi 35% gjë që tregon për një gjendje jo të mirë në klasë apo se kemi klasë të zhurmshme me mbi 35%. Ata thonë se sfidohen nga sjelljet jo të mira të nxënësve gjatë procesit mësimor, por edhe se nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e tyre që i japin. Kjo përqindje është relativisht mbi 35% gjë që duhet kushtuar shumë kujdes dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për pjesën tjetër të nxënësve.

Sipas mësimdhënësve ka shumë raste kur nxënësit flasin pa leje apo edhe zotërojnë gjuhë vulgare, por nuk mungojnë as ngacmimet në mes tyre. Ka raste kur gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme e cila pengon procesin mësimor. Ata thonë se i trajtojnë sjelljet e tyre të papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë me nxënësit, por edhe zakonisht ulen dhe diskutojnë me nxënësit për sjelljet dhe pasojat tyre. Mirëpo, ka shumë raste kur mësimdhënësit i injorojnë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.




Figura 1. Qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve

Sipas opinionit të mësimeve, ata përdorin stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme të nxënësve dhe gjithashtu fokusohen edhe në veprimet e papërshtatshme që bëjnë nxënësit. Ata thonë se në bashkëpunim me nxënësit i vendosin rregullat e klasës gjë që i bën nxënësit ta ndiejnë veten faktor me rëndësi në klasë, por edhe arrijnë të diskutojnë me ta më shumë për sjelljet e papërshtatshme krahas atyre jo të papërshtatshme.

Mësimeve shprehen se i inkurajojnë nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljet e tyre dhe se shpesh ndodh që ata i ndryshojnë sjelljet e tyre në mënyrë që të ndryshohet edhe sjellja e nxënësve në klasë. Ata shpesh e ndalojnë mësimin për adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve dhe shfrytëzojnë kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të treguar ndaj sjelljeve sfiduese.




Figura 2. Opinonet e mësime dhënëse për modifikimin e sjelljeve të papërshtatshme

Vërtetimi i hipotezave

Testimi i hipotezës së parë

Për të vërtetuar hipotezën e parë se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë përhapur shumë në klasë, është aplikuar testi i analizës faktoriale i cili mundëson përcaktimin e faktorëve të rëndësishëm.

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën 26, shohim se sipas testit të KMO dhe Bartlett test vlera e KMO = 0.807, chi-square = 707.383 me shkallë të lirisë df = 153, kurse p-value=0.000 e cila tregon se mund të vazhdojmë me analizimin e mëtutjeshëm të faktorëve.

Tabela 26. Rezultatet e testit të KMO dhe Bartlett lidhur me përhapjen e sjelljeve të nxënësve

<i>KMO and Bartlett's Test</i>			
Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.			0.807
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square		707.383
	Df		153
	Sig.		0.000

Rezultatet nga tabela 27 e konfirmojnë faktin se ndryshoret janë klasifikuar në 5 kategori apo në 5 faktorë kryesorë të cilët janë të përhapur si sjellje të papërshtatshme në klasë, pra 5 faktorë kalojnë vlerën e Eigenvalue mbi 1.

Tabela 27. Klasifikimi i ndryshoreve në kategori

<i>Total Variance Explained</i>									
Component	Initial Eigenvalues			Extraction Sums of Squared Loadings			Rotation Sums of Squared Loadings		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
1	4.260	23.669	23.669	4.260	23.669	23.669	3.012	16.731	16.731
2	2.839	15.774	39.443	2.839	15.774	39.443	2.914	16.187	32.917
3	1.254	6.964	46.408	1.254	6.964	46.408	1.987	11.038	43.956
4	1.204	6.686	53.094	1.204	6.686	53.094	1.589	8.827	52.782
5	1.095	6.084	59.178	1.095	6.084	59.178	1.151	6.395	59.178
6	0.845	4.695	63.873						
7	0.823	4.574	68.447						
8	0.751	4.174	72.621						

9	0.677	3.764	76.385
10	0.632	3.510	79.895
11	0.580	3.225	83.120
12	0.534	2.965	86.085
13	0.500	2.778	88.863
14	0.480	2.666	91.529
15	0.434	2.413	93.942
16	0.423	2.352	96.294
17	0.381	2.117	98.410
18	0.286	1.590	100.000

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Sic shihet nga figura 3, nga ndryshorja 5 ka filluar rënia andaj ndryshoret janë klasifikuar në 5 faktorë kryesor.




Figura 3. Klasifikimi i ndryshoreve në faktorë kryesor

Sipas rezultateve të analizës faktoriale, shohim se në grupin e parë si sjellje të papërshtatshme janë ndryshoret: “Mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona” (0.649), pastaj “Sfidohem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë” (0.645), “Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare” (0.756), “Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin” (0.735) dhe “Gjatë procesit

mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë” (0.762) të cilën mund ta emërtojmë si klasë e zhurmshme dhe sjellje jo të përshtatshme.

Tabela 28. Analiza e ndryshoreve

Rotated Component Matrix^a

	Component				
	1	2	3	4	5
Mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona.	0.649				
Sfidohem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë.	0.645				
Nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e dhëna.					0.907
Nxënësit në klasë flasin pa leje.					0.907
Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare.	0.756				
Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin.	0.735				
Gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë.	0.762				
I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë.		0.689			
Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre.		0.724			
Injoroj sjelljen e papërshtatshme të nxënësve.					
Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme.			0.622		
Fokusoheh vetëm në veprimet e papërshtatshme të nxënësve.					
Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës.		0.748			
Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme.		0.655			
Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre.		0.638			
Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë.			0.699		
Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.				0.655	
Shfrytëzoj kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese.					

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Varimax with Kaiser Normalization.

a. Rotation converged in 8 iterations.

Në grupin e dytë janë veçuar ndryshoret: “I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë” (0.689), “Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre” (0.724), “Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës” (0.748), “Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme” (0.655) dhe “Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre” (0.638) e të cilën e emërojmë si qasje profesionale e mësimdhënësve për të përmirësuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë.

Në grupin e tretë hyjnë ndryshoret: “Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme” (0.622) dhe “Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve

në klasë” (0.699) e të cilën e emërojmë si ndryshim i sjelljes së mësimit për të përmirësuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.

Në grupin e katërt janë ndryshoret: “Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve” (0.655) e cila tregon se mësimit praktikojnë metoda të ndryshme të komunikimit me nxënësit, e që e emërojmë si qasje e mësimit ndaj nxënësve. Kurse në grupin e pestë është ndryshorja: “ Nxënësit në klasë flasin pa leje ” (0.907) që tregon se nxënësit flasin pa rend gjatë procesit mësimor.

Me këtë mund të themi se pavarësisht sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve të cilat janë të përhapura në klasë, ka një qasje profesionale të mësimit për të ndryshuar këto sjellje duke aplikuar edhe metoda të ndryshme të komunikimit me nxënës.

Testimi i hipotezës së dytë

Për të vërtetuar hipotezën e dytë: “*Mësimit sfidohen shumë nga sjelljet e papërshtatshme*”, është aplikuar testi H_i^2 , ku është bërë krahasimi në mes gjinisë mashkullore dhe femërore të mësimit dhe sfidës që ata hasin gjatë procesit mësimor me sjelljet e papërshtatshme të nxënësve. Variabla e pavarur është gjinia e mësimit, kurse ajo e varur janë pyetjet: “mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona”, “sfidohem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë”, si dhe “gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë”.

Tabela 29. Vërtetimi i hipotezës së dytë përmes testit H_i^2

Gjinia – Chi-square / H_i^2	pearson		
	chi-square	df	p-value
Mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona.	2.339	4	0.674
Sfidohem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë.	2.328	4	0.676
Gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë.	1.424	4	0.840

Sipas rezultateve të prezantuara në tabelën 29, shohim se në rastin e parë Pearson Chi-square = 2.339, me shkallë të lirisë=4 dhe p-value = 0.674 që nënkupton se shumica e mësimitdhënësve kanë mendim të njëjtë në lidhje me sjelljet e papërshtatshme të nxënësve të cilat konsiderohet se janë të përhapura në shkollat e tyre. Gjithashtu edhe në rastin e dytë shohim se Pearson Chi-square=2.328, shkallë të lirisë=4 dhe p-value=0.676 e cila tregon se shumica mendojë njëjtë se sfidohen nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë, si dhe në rastin e tretë Pearson chi-square=1.424, shkallë të lirisë=4 dhe p-value=0.840 e cila tregon se shumica e mësimitdhënësve janë të mendimit se gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë.

Me këtë pranojmë hipotezën e dytë dhe themi se mësimitdhënësit sfidohen shumë nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve gjatë procesit mësimor.

Në figurën 4 kemi paraqitur opinionet e mësimitdhënësve lidhur me përhapjen e sjelljeve papërshtatshme të nxënësve duke i krahasuar përgjigjet e tyre me gjininë që i takojnë. Kështu te përgjigjet e pjesëmarrësve të gjinisë femërore shohim se 13.33% janë pajtuar plotësisht, 14.67% prej tyre pajtohen pjesërisht, 18.67% pajtohen mesatarisht, 16% e pjesëmarrësve nuk pajtohen pjesërisht

dhe 13.33 nuk pajtohen aspak. Ndërsa 3.33% e pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore pajtohen plotësisht, 7.33% e tyre pajtohen pjesërisht, 4.67% e pjesëmarrësve pajtohen mesatarisht, 5.33% prej tyre nuk pajtohen pjesërisht dhe 3.33% e pjesëmarrësve nuk pajtohen aspak.




Figura 4. Sjelljet e papërshtatshme të nxënësve e krahasuar me gjininë e mësimitdhënësve

Në figurën e pestë janë të paraqitura opinionet e mësimeve për deklaratën “Gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë” e krahasuar me gjininë e tyre. Kështu deklaratat e pjesëmarrësve të gjinisë femërore janë kështu: 8.67% prej tyre pajtohen plotësisht, 6.67% pajtohen pjesërisht, 12% prej tyre pajtohen mesatarisht, 20.67% nuk pajtohen pjesërisht dhe 28% nuk pajtohen aspak. Derisa 4% e pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore deklarojnë se pajtohen plotësisht, 2.67% pajtohen pjesërisht, 4% e tyre pajtohen mesatarisht, 4.67% e pjesëmarrësve nuk pajtohen pjesërisht dhe 8.67% prej tyre nuk pajtohen aspak.




Figura 5. Krijimi i zhurmës në klasë krahasuar me gjininë e mësimeve

Në figurën e 6 janë të paraqitura përgjigjet e mësimeve për deklaratën “Sfidohem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë” të krahasuara njëra me tjetrën në bazë të gjinisë së mësimeve. Kështu përgjigjet e mësimeve të gjinisë femërore janë si vijon: 10% prej tyre pajtohen plotësisht, 9.33% pajtohen pjesërisht, 20% prej tyre pajtohen mesatarisht, 18% e mësimeve nuk pajtohen pjesërisht dhe 18.67% nuk pajtohen aspak. Ndërsa 2% e mësimeve të gjinisë mashkullore pajtohen plotësisht, 4.67% prej tyre pajtohen pjesërisht, 7.33% nga ata pajtohen mesatarisht, 4% nuk pajtohen pjesërisht dhe 6% nuk pajtohen aspak.




Figura 6. Sfida e mësimeve nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë

Testimi i hipotezës së tretë

Për të analizuar hipotezën e tretë: *“Mësuesit përdorin llojllojshmëri metodash për menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme në procesin mësimor”*, gjithashtu është aplikuar testi H_i^2 , ku variabla e pavarur është gjinia e mësimeve, kurse variabla të varura janë pyetjet: “Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme”, “Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës”, “Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e papërshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme”, “Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre”, “Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë”, “Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve”, si dhe “Shfrytëzoj kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese”.

Sipas rezultateve të prezantuara në tabelën 30, shohim se në asnjërin nga rastet nuk ka dallime sinjifikante gjë që tregon se shumica e mësimeve janë të mendimit se ata aplikojnë llojllojshmëri metodash për menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve gjatë procesit mësimor.

Saktësisht në rastin e parë tek përdorimi i stimujve përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme (Pearson chi-square=4.230, df=4, p-value=0.376), pastaj tek ajo se bashkë me nxënësit vendosin rregullat e klasës (Pearson chi-square=5.369, df=5, p-value=0.373), diskutojnë me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas atyre të papërshtatshme (Pearson chi-square=2.783, df=5, p-value=0.733), pastaj tek rastet kur i inkurajojnë të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre (Pearson chi-square=7.098, df=4, p-value=0.131), ndryshimi i sjelljeve të mësimdhënësve në mënyrë që të ndryshohen sjelljet e nxënësve në klasë (Pearson chi-square=1.123, df=4, p-value=0.891), pastaj ndalimi i mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve (Pearson chi-square=1.831, df=4, p-value=0.767) dhe shfrytëzimi i kohës për të përdorur më shumë strategji parandaluese se sa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese (Pearson chi-square=4.035, df=4, p-value=0.401), tregon se opinioni i mësimdhënësve është i njëjtë dhe se ata aplikojnë metoda të ndryshme të menaxhimit të sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve.

Tabela 30. Vërtetimi i hipotezës së tretë përmes testit H_i^2

Gjinia – Chi-square / H_i^2	<i>pearson</i>		
	<i>chi-square</i>	<i>df</i>	<i>p-value</i>
Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme.	4.230	4	0.376
Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës.	5.369	5	0.373
Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme.	2.783	5	0.733
Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre.	7.098	4	0.131
Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë.	1.123	4	0.891
Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.	1.831	4	0.767
Shfrytëzoj kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese.	4.035	4	0.401

Në figurën e shtatë kemi krahasuar deklaratat e mësimitdhënësve në mes vete lidhur me qëndrimin që kanë ata ndaj sjelljeve të papërshtatshme. Kështu për deklaratën “Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve”, 22% e mësimitdhënësve të gjinisë femërore pajtohen plotësisht 20% prej tyre pajtohen pjesërisht, 18% e tyre pajtohen mesatarisht, 6% nga pjesëmarrëset nuk pajtohen pjesërisht dhe 10% prej tyre nuk pajtohen aspak. 6% e pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore pajtohen plotësisht, 5.33% e tyre pajtohen pjesërisht dhe mesatarisht, 2% prej tyre nuk pajtohen pjesërisht dhe 5.33% e tyre nuk pajtohen aspak.




Figura 7. Qëndrimi i mësimitdhënësve në mësim gjatë paraqitjes së sjelljeve të papërshtatshme

Më poshtë (figura 8), kemi krahasuar mendimet e pjesëmarrësve të gjinisë femërore dhe mashkullore për deklaratën “Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës”. Kështu shohim se 48.67% e pjesëmarrësve të gjinisë femërore pajtohen plotësisht, 13.33% pajtohen pjesërisht, 4% prej tyre mesatarisht, 3.33% nuk pajtohen pjesërisht dhe 5.33% nuk pajtohen aspak. 13.33% e mësimdhënësve të gjinisë mashkullore pajtohen plotësisht, 3.33% pajtohen pjesërisht, 2% prej tyre mesatarisht, 3% e tyre nuk pajtohen pjesërisht dhe 2% e mësimdhënësve nuk pajtohen aspak.




Figura 8. Vendosja e rregullave të klasës bashkë me nxënësit

Në figurën e 9 është bërë krahasimi i deklaratave të mësimdhënësve sipas gjinisë së tyre. Kështu për deklaratën “Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme” shohim se 36.7% e mësimdhënësve në gjininë femërore pajtohen plotësisht, 17.33% pajtohen pjesërisht, 6% prej tyre mesatarisht, 8% nga ato nuk pajtohen pjesërisht dhe 7.33% nuk pajtohen aspak. Ndërsa 14% nga mësimdhënësit e gjinisë mashkullore pajtohen plotësisht, 3.33% pajtohen pjesërisht, 2.67% prej tyre pajtohen mesatarisht dhe nuk pajtohen aspak, 1.33% nuk pajtohen aspak.




Figura 9. Diskutimi i sjelljeve të përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme

Më poshtë kemi krahasuar qëndrimet e mësimitdhënësve lidhur me inkurajimin e nxënësve për vetëvlerësimin e sjelljes së tyre. 41.33% e mësimitdhënësve në gjininë femërore deklaruan se pajtohen plotësisht, 12% prej tyre pajtohen pjesërisht, 6% e mësimitdhënësve pajtohen mesatarisht dhe nuk pajtohen pjesërisht, 10.67% prej tyre nuk pajtohen aspak. 10.67% e mësimitdhënësve në gjininë mashkullore pajtohen plotësisht, 8.67% pajtohen pjesërisht, 1.33% pajtohen mesatarisht dhe nuk pajtohen pjesërisht, 2% prej mësimitdhënësve nuk pajtohen aspak.




Figura 10. Inkurajimi i nxënësve për vetëvlerësimin e sjelljeve nga ana e mësimitdhënësve

Sa i përket deklaratës “Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë” deklaratimet e klasifikuara në bazë të gjinisë së mësimitdhënësve është si vijon: 33% e mësimitdhënësve në gjininë femërore pajtohen plotësisht, 17.33% e tyre pajtohen pjesërisht, 9.33% pajtohen mesatarisht, 7.33% e mësimitdhënësve nuk pajtohen pjesërisht dhe 8.67% nuk pajtohen aspak. Mësimitdhënësit meshkujt deklaruan se 11.3% pajtohen plotësisht, 5.33% pajtohen pjesërisht, 3.33% e mësimitdhënësve pajtohen mesatarisht, 2.67% nuk pajtohen pjesërisht dhe 1.33% nuk pajtohen aspak.




Figura 11. Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë

Në figurën 12 kemi rezultatet e deklarimeve të mësimdhënësve të krahasuara me gjininë e tyre. Për deklaratën “Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve”, 22% e mësimdhënësve në gjininë femërore janë pajtuar plotësisht, 20% e tyre janë pajtuar pjesërisht, 18% nga ato janë pajtuar mesatarisht, 6% e mësimdhënësve nuk pajtohen pjesërisht dhe 10% nga ato nuk pajtohen aspak. Ndërsa në anën tjetër 6% e pjesëmarrësve në hulumtim në gjininë mashkullore janë pajtuar plotësisht, 5.33% e tyre janë pajtuar pjesërisht dhe mesatarisht me të njëjtën vlerë, 2% nga ata nuk pajtohen pjesërisht dhe 5.33 nuk pajtohen aspak.




Figura 12. Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve

Sa i përket përdorimit të strategjive parandaluese ndaj sjelljeve deklarimet e mësimdhënësve të krahasuara sipas gjinisë së tyre paraqitet kështu: Nga 34.67% e pjesëmarrësve në hulumtim në gjininë femërore pajtohen plotësisht, 19.33% pajtohen pjesërisht, 7.33% pajtohen mesatarisht, 3.33% e pjesëmarrësve në hulumtim nuk pajtohen pjesërisht dhe 11.33% nuk pajtohen aspak. Në anën tjetër 8.67% e mësimdhënësve që u takojnë gjinisë mashkullore 8.67% e tyre pajtohen plotësisht, 9.33% pajtohen pjesërisht dhe nga 2% e tyre kanë deklaruar se pajtohen mesatarisht, nuk pajtohen pjesërisht dhe nuk pajtohen aspak.




Figura 13. Përdorimi i strategjive parandaluese ndaj sjelljeve sfiduese

V. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Mësimdhënia është një proces unik edukativo-arsimor e cila përcillet me shumë problematika dhe sfida. Duke u bazuar në sfidat që ofron mësimdhënia bashkëkohore qëllimi i këtij studimi ishte të vërtetohet shkalla e përhapjes së sjelljeve të papërshtatshme në klasat tona, sfidat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit me këto sjellje dhe metodat që përdorin ata për evitimin dhe parandalimin e këtyre sjelljeve. Qasja metodologjike që zgjedhin mësimdhënësit për trajtimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve paraqet pikën kyçe të disiplinës pozitive në klasë e cila ka ndikim të madh në të arriturat akademike të nxënësve, andaj edhe ky studim ofron kontribut relativisht të madhe fushës arsimore, duke iu referuar të gjithë mësimdhënësve dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit me qëllim të trajtimit në mënyrë të duhur të sjelljeve të papërshtatshme dhe ngritjes së cilësisë profesionale të mësimdhënësve për ballafaqimin në situata të tilla sfiduese.

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 150 mësimdhënës të shkollave fillore të Komunës së Prizrenit duke përfshirë zonat urbane dhe rurale. Përfshirja më e madhe e pjesëmarrësve ishte në zonat urbane me 64% ndërsa në zonat rurale ishte 36%.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve u takonin gjinisë femërore 114 prej tyre apo 76%, ndërsa pjesëmarrësit e gjinisë mashkullore ishin 36 apo 24% e tyre.

Grup moshë më e theksuar e pjesëmarrësve ishte mbi 50 vjeç me 33.3% ,derisa grup moshë më pak e paraqitur ishte 22-30 vjeç me 14.7%.

Niveli i shkollimit pjesës më të madhe u takonte gradës Bachelor 111 prej tyre apo 74%, më pas grada Master 23 prej tyre apo 15.3%, me Shkollë të lartë 10 prej tyre apo 6.7% dhe së fundmi me Doktoratë 6 prej tyre ose 4%.

Duke u bazuar edhe nga grup moshat më të theksuara të pjesëmarrësve nënkuptohet që pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë përvojë pune mbi 10 vite 56.7% apo 85 prej tyre derisa përvoja e punës 4-6 vite është më së paku e shfaqur 8.7% apo 13 prej tyre.

16.7% e mësimdhënësve pajtohen plotësisht se sjelljet e papërshtatshme janë të përhapura në klasa, përderisa 22% e tyre pajtohen pjesërisht, 23.3% pajtohen mesatarisht, 21.3% nuk pajtohen pjesërisht dhe 16.7% e tyre nuk pajtohen aspak në përhapjen e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve. Sjelljet e papërshtatshme 12% të mësimdhënësve i sfidojnë plotësisht, 21% pjesërisht, 27.3% mesatarisht, 24.7% aspak nuk i sfidon.

Në bazë të rezultateve të fituara nga analiza e të dhënave mësimdhënësit konsiderojnë se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat e tyre dhe kjo përqindje shkon mbi 35% gjë që tregon për një gjendje jo të mirë në klasë apo se kemi klasë të zhurmshme me mbi 35%.

Ata thonë se sfidohen nga sjelljet jo të mira të nxënësve gjatë procesit mësimor, por edhe se nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e tyre që i japin. Kjo përqindje është relativisht mbi 35% gjë që duhet kushtuar shumë kujdes dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për pjesën tjetër të nxënësve.

Si në të gjeturat në raportin e Elton (Elton L. , 1989) ku theksohet se sjelljet më të shpeshta janë ato të folurit pa leje dhe jashtë radhe nga nxënësit të cilat po shkaktojnë stres të madh te mësimdhënësit, ashtu edhe në të gjeturat e këtij studimi, shqetësimi më i madh i mësimdhënësve vjen nga të folurit pa leje, një pjesë e madhe e mësimdhënësve pajtohen se nxënësit flasin pa leje, pra kemi 23 apo 15.3% të mostrës, 28 thonë se kjo ndodh pjesërisht apo 18.7%, 21 thonë se kjo ndodh mesatarisht apo 14%, pjesërisht nuk pajtohen janë 33 apo 22% dhe 44 nuk pajtohen aspak apo 29.3%.

Sikur që është vërtetuar në vlerësimin multifaktorial të cilësisë së arsimit në shkollat 9-vjeçare shqiptare (Tamo & Karaj, 2007), ku 67% e vëzhguesve pohuan se mësuesit tërheqin herë pas here vëmendjen për ruajtjen e qetësisë në klasë, edhe në këtë studim është vërtetuar se mësimdhënësit në mase të madhe ndalojnë mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve 28% pajtohen plotësisht, pajtohen pjesërisht apo 25.3%, mesatarisht 23.3%, nuk pajtohen pjesërisht 8% dhe nuk pajtohen aspak 15.3%.

Ngjashëm me të gjeturat nga studimi i (Zabeli, 2008) ku është vërtetuar se 35.01% e mësimdhënësve shfrytëzojnë kohën gjithnjë për reduktimin e sjelljeve të papërshtatshme, 42.80% shfrytëzojnë shpeshherë, 16.34% shfrytëzojnë ndonjëherë. 3.89% shfrytëzojnë pak herë dhe 1.94% nuk shfrytëzojnë fare edhe në këtë hulumtim rezultatet qëndrojnë të afërta sa i përket shfrytëzimit të kohës për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese, 43.3% e mësimdhënës pajtohen plotësisht , pajtohen pjesërisht 28.7%, mesatarisht janë 9.3%, nuk pajtohen pjesërisht janë 5.3% dhe nuk pajtohen aspak janë 20 apo 13.3%.

Ngjashëm me të gjeturat ndërkombëtare që fuqizojnë praninë e sjelljeve të papërshtatshme gjatë procesit mësimor, edhe ky studim pohon se sjelljet e papërshtatshme janë të përhapura në klasat tona me të cilat mjaft shumë sfidohen edhe mësimdhënësit tanë.

Rëndësia e studimit të kësaj teme nuk është vetëm në favor të mësimdhënësve, por ajo mbetet e rëndësishme edhe për prindërit, për të cilët mund të jetë një udhërrëfyes për edukimin e fëmijëve, pasi që të gjithë e dimë se baza e çdo sjelljeje merret në moshën e hershme fëmijërore, në shoqërinë familjare ku prindërimi dhe rrethi luan një rol të rëndësishëm për të ardhmen e individit.

Kufizimet e studimit

Ky studim i realizuar ndeshet me disa kufizime, të cilat kanë ndikuar në rrjedhën e punës, vlefshmërisë dhe përgjithësisht të rezultateve të fituara.

Kufizimi më i madh i këtij studimi është mostra e zgjedhur për këtë hulumtim, pasi që 150 mësimdhënësit e përzgjedhur përfaqësojnë 516 mësimdhënësit e SH.F.M.U të komunës së Prizrenit. Natyrisht, kjo paraqet një kufizim nëse duam t'i përgjithësojmë rezultatet për gjithë popullacionin.

Kufizimi tjetër me rëndësi është mungesa e informatave dhe sqarimeve shtesë gjatë plotësimit të pyetësorëve nga ana e mësimdhënësve. Edhe pse gjatë shpërndarjes së pyetësorëve u janë dhënë udhëzimet e nevojshme pjesëmarrësve në hulumtim, ata kanë pasur nevojë për sqarime të mëtutjeshme dhe si rezultat i saj përgjigjet e dhëna mund të jenë sipërfaqësore.

Së treti, tek pyetjet demografike, përkatësisht rubrika ku kërkohet emri i institucionit, kishte ndikim në gjendjen emocionale të mësimdhënësve, ngase ata druheshin që përgjigjet do të kontrolloheshin nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe do të gjykoreshin për zgjidhjet e dhëna, andaj kjo ndikoi në devijimin e një pjese të përgjigjeve të tyre.

Hulumtimet në të ardhmen

Ky hulumtim i realizuar është mjaft i rëndësishëm në fushën teorike dhe praktike të arsimit. Për ata të cilët synojnë të shtjellojnë dhe të zgjerojnë këtë temë i rekomandojmë:

- Të përfshijnë një numër më të madh të mësimitdhënësve si mostër me qëllim që të dhënat të përgjithësojnë pjesën më të madhe të popullacionit dhe të jenë më të vlefshme.
- Të zgjerojnë hulumtimin rreth metodave psiko-pedagogjike për trajtimin e sjelljeve të papërshtatshme.
- Të analizojnë ndikimin e sjelljeve të papërshtatshme në arritjet akademike të nxënësve.

Implikimet praktike nga studimi

Rezultatet e arritura përmes këtij studimi iu referohen mësimitdhënësve në radhë të parë duke iu rekomanduar atyre të përdorin stimuj, strategji dhe metoda nga më të ndryshme për parandalimin e situatave problematike dhe krijimin e një atmosfere sa më pozitive në klasë.

Pavarësisht që rezultatet pohojnë se mësimitdhënësit përdorin llojllojshmëri metodash për trajtimin e sjelljeve të papërshtatshme, Drejtorisë Komunale të Arsimit iu rekomandohet të organizojnë trajnime për mësimitdhënësit lidhur me menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme në nivel vendi me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës gjatë procesit mësimor.

Rëndësia e studimit të kësaj teme nuk është vetëm në favor të mësimitdhënësve, por ajo mbetet e rëndësishme edhe për prindërit, për të cilët kjo, mund të jetë një udhërrëfyes për edukimin e fëmijëve, pasi që të gjithë e dimë se baza e çdo sjelljeje merret në moshën e hershme fëmijërore, në shoqërinë familjare ku prindërimi dhe rrethi luan një rol të rëndësishëm për të ardhmen e individit.

VI. BIBLIOGRAFIA

- Abrahamse, M., Junger, M., Wouwe, M., Boer, F., & Lindauer, R. (2015). Treating Child Disruptive Behavior in High-Risk Families: A Comparative Effectiveness Trial from a Community-Based Implementation. *Journal of Child and Family Studies*, 25(5), 1605–1622.
- Alderman, G. L., & Green, S. K. (2011). Social powers and effective classroom management: Enhancing teacher-student relationship. *Intervention in School and Clinic*, 47(1), 39-44.
- Allday, A., & Pakurar, K. (2007). Effects of teacher greetings on student on- task behavior. *Journal Applied Behavior Analysis*, 40(2), 317-20.
- Araban, M., Montazeri, A., Stein, L., Karimy, M., & Mehrizi, A. (2020). Prevalence and factors associated with disruptive behavior among Iranian students during 2015: a cross-sectional study. *Italian Journal of Pediatrics*, 46(1), 2-7.
- Basar, H. (1994). *Classroom menagement*. Ankara: Pegem House.
- Canter, L. (2014). *Classroom Management for Academic Success*. New York: Solution Tree.
- Canter, L., & Canter, M. (1993). *Succeeding with difficult students: New strategies for reaching your most challenging students*. Santa Monica: Solution Tree.
- Canter, L., & Canter, M. (2001). *Positive behavior management for today's classroom*. Bloomington: Solution Tree.
- Charles, C. M., & Senter, G. W. (2004). *Building Classroom Discipline*. Boston: Allyn & Bacon.
- Corey, G. (2009). *Theory and practice of counseling and pyschotherapy*. Boston: Belmon, CA: Thomson Brooks/Cole.
- Curwin, R., & Mendler, A. (2018). *Discipline with dignity*. Alexandria: Association for Supervision and Curriculum.

- Curwin, R., & Mendler, A. (2018). *Discipline with dignity*. Alexandria: Association for Supervision and Curriculum.
- Dreikurs, R. (1968). *Psychology in the Classroom. A Manual for Teachers*. London: Harpercollins.
- Dreikurs, R. (1975). *Fundamentals of Adlerian Psychology* . Chicago: Adler School of Professional.
- Dreikurs, R., & Soltz, V. (1985). *Happy Children : A Challenge to Parents*. Glasgow: Fontana.
- Elton, L. (1989). *Discipline in School*. London: Her Majesty's Stationery Office.
- Elton, L. (1989). *Discipline in School*. London: Her Majesty's Stationery Office.
- Fayol, H. (1949). *General and industrial management* . London: Pitman.
- Glasser, W. (1965). *Reality Therapy. A new approach to psychiatry*. New York: Harper & Row.
- Glasser, W. (1965). *Take effective control of your life*. New York: Harper & Row.
- Glasser, W. (1969). *Schools without failure* . New York: Harper and Row.
- Glasser, W. (1985). *Control theory in the classroom*. New York: Perennial Library.
- Glasser, W. (1998). *Choice Theory in the Classroom*. New York: Harper Perennial.
- Gordon, T. (1991). *Discipline That Works*. New York: Plume.
- Gordon, T. (1991). *Discipline That Works: Promting Self-Discipline in Children*. New York: Plume.
- Gordon, T., & Brunch, N. (2003). *Teacher Effectiveness Training: The Program Proven to Help Teachers Bring Ot the Best in Students of al Ages*. New York: Crown.
- Griffiths, T., Millei, Z., & John, R. (2010). *Re-theorizing discipline in education: Problems, politics, & possibilities*. New York: Peter Lang Frank.
- Grillo, K. (2002). *Fjalor edukimi- Psikologji, Sociologji, Pedagogji*. Tiranë: Instituti i studimeve Pedagogjike.

- Guzledere-Aydin, D., & Ocak-Karabay, S. (2020). Improvement of Classroom Management Skills of Teachers Leads to Creating Positive Classroom Climate. *International Journal of Educational Research Review*, 5(1), 10-25.
- Hardin, J. (2004). *Effective Classroom Management*. Boston: Pearson.
- Houghton, S., Wheldall, K., & Merrett, F. (1988). Classroom behaviour problems which secondary school teachers say they find most troublesome. *British Educational research Journal*, 14(3), 297-312.
- Hunter-Lowe, M. (2008). *Qualitative Anaysis of Distruptive Behavior and Lidership Influence in Two Urban K-6 Virginia Elementary Schools Public Schools*. Florida USA: Disertation.
- Jimerson, Anderson, & Whipple. (2002). Winning the battle and losing the war: Examining the relationship between grade retention and dropping out of high school. *Psychology in the School*. *Psychology in the Schools*, 39(4), 441-457.
- Johansen, A., Little, G., & Little, A. (2011). Ann examination of New Zealand teachers' attributions and perceptions of behaviour, Classroom management and the level of formal teacher training received in behaviour management. *Kairaranga The Journal of New Zealand Resource Teacher of Learning and Behaviour*, 12, 3-12.
- Jung, J., & Boman, P. (2003). Comparison of disruptive behaviours in South Australian LOTE and mainstream primary school classrom. *Journal of Educational Enquiry*, 4(2), 90-101.
- Kern, L., & Clemens, N. H. (2007). Antecedent strategies to promote appropriate classroom behavior. *Psychology in the Schools*, 44(1), 65-75.
- Kounin, J. (1970). *Discipline and group management in classrooms*. New York: Holt, Rinehart & Winston.
- Little, E., & Arbuckle, C. (2004). Teachers' Perceptions and Management of Disruptive Classroom Behaviour During the Middle Years (years five to nine). *Australian Journal of Educational & Developmental Psychology*, 4, 59-70.
- Mathew, L. (2016). *Reality therapy: What educators need to know about glasser's approach to classroom management*. Richmond: The Edvocate.

- Molen, E., Hipewell, A., & Rolf, R. (2011). Maternal characteristics predicting young girls' disruptive behavior. *Journal of Clinical Child & Adolescent Psychology*, 40(2), 179–190.
- Musai, B. (2003). *Metdologji e mësimdhënies*. Tiranë: ALBGRAF.
- Ohju, D. (2010). Effect of Reality Therapy Group Program to Improve Self Esteem and Problem Coping Behavior of Students with Multiple Experiences of School Violence. *Journal of the Korean Psychological Association: School*, 7(1), 37-53.
- Passaro, Moon, Wiest, & Wong. (2004). A model for school psychology practice: addressing the needs of students with emotional and behavioral challenges through the use of an in-school support room and reality therapy. *Adolescence*, 39(155), 503-517.
- Platt, A. (1979). *Efficacy of class meetings in elementary schools*. Sacramento: California State University.
- Rather, A. (2004). *Essentials Of Instructional Technology*. New Delhi: Discovery Publishing House.
- Rogers, B., & McPherson, E. (2014). *Behaviour Management With Young Children*. London: Sage Publications.
- Sagal, T. (1981). *Skinner's Philosophy*. Washington: University Press of America.
- Simpson, J., & Weiner, E. (1989). *Oxford English Dictionary*. Oxford: Clarendon Press.
- Skinner, B. F. (1938). *The Behaviour of organisms: An experimental analysis*. New York: Appleton-Century.
- Sutherland, K. S., Lewis-Palmer, T., Stichter, J., & Morgan, P. L. (2008). Examining the influence of teacher behaviour and classroom context on the behavioural and academic outcomes for students with emotional or behavioural disorders. *Journal of Special Education*, 41(4), 223-233.
- Tamo, A., & Karaj, T. (2007). *Studim: Kënaqësia e mësuesve shqiptarë nga puna e tyre*. Tiranë: MESS.

- Tattum, D. P. (1982). *Disruptive Pupils in Schools and Units*. Chichester: John Wiley and Sons.
New York: John Wiley & Sons Inc.
- Todras, P. (2007). *Teachers perspectives of disruptive behavior in the classroom*. Charleston: Proquest, Umi Disertation .
- Twenge, J., & Campbell, K. (2009). *The Narcissism Epidemic : Living in the Age of Entitlement*. New York: Free Press (Simon and Schuster).
- Walter, E. (1995). *Cambridge English Dictionary*. Cambridge: Cambridge University.
- Wubbolding, R. (2015). The Voice of William Glasser: Accessing the Continuing Evolution of Reality Therapy. *Journal of Mental Health Counseling*, 37(3), 189-205.
- Zabeli, N. (2008). *Strategjitë psiko-pedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë*. (Disertacion i Doktoratës, Universiteti i Prishtinës). Prishtinë: Libri shkollor.

SHTOJCA: PYETËSORI

Mësimdhënës të nderuar,

Unë jam Mjellma Shala, studente e nivelit Master në Fakultetin e Edukimit – drejtimi Edukimi Inklusiv, të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Në kuadër të punimit të diplomës e cila mban titullin: *“Metodat e punës dhe sfidat për menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve”* së bashku me mentoren Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli kemi përgatitur këtë pyetësor.

Ky pyetësor ka për qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme përmes së cilit do të analizohen qëndrimet e mësimdhënësve rreth metodave të menaxhimit të sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve dhe sfidave që u ofrojnë këto sjellje në përvojën e tyre.

Ju drejtohem me kërkesë që të më ofroni përgjigjet tuaja lidhur me pyetjet e mëposhtme.

Ju siguroj se përgjigjet tuaja do të jenë plotësisht konfidenciale dhe se të njëjtat do të shfrytëzohen vetëm për qëllimin e këtij hulumtimi.

Pyetësori përbehet nga dy pjesë:

I. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Përmes pyetësorit, në këtë pjesë synohet të mblidhen të dhënat e juaja të përgjithshme si pjesëmarrës të këtij hulumtimi.

II. METODAT E PUNËS DHE SFIDAT PËR MENAXHIMIN E SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME TË NXËNËSVE

Në këtë pjesë synohet të mblidhen informacionet lidhur me shkallën e përhapjes së sjelljeve të papërshtatshme në klasat e juaja, sfidat që u ofrojnë këto sjellje dhe identifikimin e metodave të punës për menaxhimin e situatave të tilla.

JU FALEMINDERIT!

I. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

1. Emri i institucionit ku punoni: <hr/>
2. Vendi i shkollës: a) Fshat b) Qytet
2. Gjinia: a) Femër b) Mashkull
3. Moshë: a) 22-30 vjeç b) 31-40 vjeç c) 41-50 vjeç d) mbi 50 vjeç
4. Niveli i shkollimit: a) Shkolla e lartë b) Bachelor c) Master d) Doktoratë
5. Përvoja e punës: a) 1-3 vite b) 4-6 vite c) 7-10 vite d) Më shumë se 10 vite

II. METODAT E PUNËS DHE SFIDAT PËR MENAXHIMIN E SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME TË NXËNËSVE

Udhëzim: Ju lutem plotësoni pyetësonin duke vendosur shenjën \checkmark në rubrikat përkatëse!

		<i>Pajtohem plotësisht</i>	<i>Pajtohem pjesërisht</i>	<i>Mesatarisht</i>	<i>Nuk pajtohem pjesërisht</i>	<i>Nuk pajtohem aspak</i>
1.	Mendoj se sjelljet e papërshtatshme të nxënësve janë të përhapura në klasat tona.					
2.	Sfidohehem nga sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në klasë.					
3.	Nxënësit nuk i zbatojnë menjëherë udhëzimet e dhëna.					
4.	Nxënësit në klasë flasin pa leje.					
5.	Nxënësit zotërojnë gjuhë vulgare.					
6.	Nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin.					
7.	Gjatë procesit mësimor krijohet zhurmë e panevojshme në klasë.					
8.	I trajtoj sjelljet e papërshtatshme shpejtë, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të qartë.					
9.	Zakonisht ulem dhe diskutoj me nxënësit për sjelljet dhe pasojat e tyre.					
10.	Injoroj sjelljen e papërshtatshme të nxënësve.					

11.	Përdor stimuj përforcues për të modifikuar sjelljen e papërshtatshme.					
12.	Fokusohe vetëm në veprimet e papërshtatshme të nxënësve.					
13.	Bashkë me nxënësit vendosim rregullat e klasës.					
14.	Diskutoj me nxënësit më shumë për sjelljet e përshtatshme krahas sjelljeve të papërshtatshme.					
15.	Inkurajoj nxënësit të vetë-vlerësojnë sjelljen e tyre.					
16.	Ndryshoj sjelljen time në mënyrë që të ndryshohet sjellja e nxënësve në klasë.					
17.	Ndaloj mësimin për të adresuar sjelljet e papërshtatshme të nxënësve.					
18.	Shfrytëzoj kohën për të përdorur më shumë strategji parandaluese sesa për të reaguar ndaj sjelljeve sfiduese.					

Data: _____

Nënshkrimi: _____